| 5 | Gjithsej dëme në biznese, në qershor 2024 | **153,011.84** |
| **Gjithsej** | | **2086887.84 euro** |

**Tabela 8: Gjithsej dëme tëpërmbledhura sipas kategorizimit**

| Nr. Ren | Përshkrimi i dëmit | Shuma e dëmit në euro(€) |
|---|---|---|
| 1 | Gjithsej dëme në Bujqësi, në prill-qershor 2023 | **1,526,708.00** |
| 2 | Gjithsej dëme në ekonomi familjare- në mars-korrik 2023 | **407,168.00** |
| 3 | Gjithsej dëme në biznese - në qershor 2023 | **153,011.84** |
| **Gjithsej dëme të shkaktuara në territorin e komunës në Vushtrri nga FNFT, gjatë muajve nëntor, dhjetor 2022 dhe janar, shkurt dhe mars 2023** | | **2086887.84 euro** |

***Dëmet në territorin e Komunës së Vushtrrisë të shkaktuara nga FNFT, në muajët-mars, prill, maj, qershor dhe korrik 2023, kapin vlerën 2,086 887.84 €***

950/23

24.07.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr.10, Tel.+383/38 20042402 , E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | **KPF dhe Kuvendin e Komunës** |
| CC | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH | |
| NGA/OD/FROM: | **Ferit Idrizi**<br>Kryetar i Komunës |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Procesverbali nga takimi publik me qytetarë, - iu dërgohet |

Të nderuar anëtar të KPF dhe Kuvendit të Komunës,

Në pajtim me nenin 66 paragrafi 8 i Statutit të Komunës, bashkëngjitur me këtë akt-përcjellës iu dërgojmë Procesverbalin nga takimi publik i Kryetarit të Komunës me qytetarë, mbajtur më 30 qershor 2023.

KPF dhe kuvendi duhet të shqyrtojnë kërkesat e qytetarëve nga takimi publik dhe njoftojnë parashtruesit e kërkesave për vendimin i cili do të merret në kuvend lidhur me kërkesat e tyre.

Shtojcë: Procesverbali

Republika e Kosovës

769-2/23
-03-
30.06.2023

Komuna Vushtrri

# PROCESVERBAL

## TAKIMI PUBLIK ME QYTETAR

**Mbajtur më 30.06.2022 ora 11:00 në sallën e Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina"**

**Pjesëmarrës: 49 qytetarë**

**Ferit Idrizi- Kryetari i Komunës –** Paraqiti fjalën hyrëse me ç'rast i njoftoj të pranishmit me projektet që jan duke u realizuar si dhe ato që do të realizohen deri në fund të vitit 2023.

Në fushën e bujqësinë ku kemi subvencionim me 100% në IADK për profile për fuqizimin e grave dhe vajzav në përpunim të ushqimit, pastaj marrëveshje me "Islamik Relief" për ndërtimin e 273serave.

Subvencionimi i bujqve për ujitje me 50% për të mbjellat bujqësore, subvencionimi për 0.05cent në litër qumësht bletarët do të subvencionohen me 4euro për koshere bletësh etj.

Sa i përket Arsimit kemi subvencionuar me bursa studentet që studiojnë brenda dhe jashtë vendit. Sipa marrëveshjes së mirëkuptimit kemi siguruar 10 bursa për student që të studiojnë në Athinë, pastaj subvencionohe 100%,të rinjtë për aftësime në qendrën e trajnimeve gjermane "Diakone Trening Center". Financohen kurse pë të rinjtë dhe të reja në mësimin e gjuhës gjermane, kompjuterë, organizojmë gara për motivim të nxënësve k edhe shpërblehen edhe profesorët edhe nxënësit më të suksesshëm.

Janë bërë meremetime të shkollave fushave sportive etj.

Në sektorin e shëndetësisë kemi Marrëveshje me Islamic Relief - shërbime për pacient, subvencionim për fëmijë e porsalindur, subvencionim për rastet për shërim, pagesë të qirasë për familje në nevojë, subvencionim të OJQ ve etj.

Kemi projekte 2vjeqare për rrugët si dhe për rregullim të shtratit të lumit "Podranqe" dhe lumit "Terstena"

Është bërë pastrimi i lumenjve dhe gjendja është shumë më mirë për shkak të punëve që janë bërë. Kanalizim me 200 projekte në realizim 95% të projekteve janë zotu për të vazhduar me projekte.

Kemi dal në inspektim të operatorëve, ku ju kanë ndal punimet dhe nuk do të lejohet të kryhen punët në tere jashta projektit.

Sa i përket Ujësjellësit kemi probleme për shkak të gypave të vjetruar. Pjesën e Qyqavicës, do të mundohemi t bëjmë furnizimin përmes bazentit në Mihaliq si dhe pjesët tjera të Komunës së Vushtrrisë brenda 2viteve.

Kabllot e qytetit janë larguar në bashkëpunim me operatorët e internetit dhe KEDS.

Në sektorin e kulturës kemi patur shumë aktivitete kulturore e sportive në çdo datë festive si për Pavarësi, Dita Çlirimit të Vushtrrisë, Dita ndërkombëtare e Fëmijëve me aktivitete të shumta kulturore balet , teatër, ansambël biblioteka etj.

Për shkak të vërshimeve situata në disa pjesë të qytetit është rënduar meqë rast vërshimet shkaktuan dëme materiale ku komisioni për vlerësim të dëmeve do të bëjnë vlerësimin dhe Komuna do të mundohet të ju dalë në ndihmë me aq sa ka mundësi por edhe Ministria.

Në ndihmë për qytetarët kanë dal kompani, shoqata e peshkatarëve.

Do të punohet edhe ditën e shtunë për bashkatdhetarët nga diaspora në mënyrë që të kenë më të lehtë në pajisjen me dokumente.

**Diskutimet nga qytetarët**

**Burim Hetemi – Vushtrri –** a do të largohet trafo tek posta e qytetit?

**Kryetari –** jemi duke e hartuar projektin për rregullim të qytetit.

**Emin Hyseni – fsh. Begaj-** në fshat nuk ka ndriçim, nga punimet në Autostradë na është dëmtuar rruga si dh kemi dëme nga vërshimet.
**Kryetari** – do të dal të ju vizitoj dhe sa i përket ndriçimit Kompania "Përparimi" do të bëj mirëmbajtjen ndriçimit dhe do të zgjidhet ai problem. Si dhe kemi projekt për Rrugë "Bekim Berisha" që do të punohet në at pjesë.

**Sadik Hajdari – fsh. Mihaliq** – rruga në lagjen tonë është e pa shtruar jemi diku 11 shtëpi, si dhe ka banor që kanë zënë rrugën.
**Kryetari** – do të ketë projekte dhe rruga do të rregullohet si dhe do të lirohen hapësirat e uzurpuara.

**Ismajl Haziri – Bashkësia Lokale "Dardania"** është një kompani që po uzurpon rrugën "Ismet Haziri".
**Kryetari** – Do të merremi me këtë çështje.

**Halil Beka- Vushtrri-** Në rrugën "Arsim Muzaqi" po kemi probleme gjatë vërshimeve. Si dhe tjetër problen kam me bllokimin e derës së lokalit te sheshi.
**Remzi Ahmeti –Drejor për Kadastër dhe Pronë** – ju kemi dërguar urdhëresë të gjitha objekteve te parku qytetit që të vinë në kadastër dhe të regjistrohen.

**Sahit Curri- Reznik** – Kanalizimi i shtëpisë del në kanal të Ibër Lepencit që është gjë e keqe dhe duhet t rregullohet.
**Nexhat Merovci – Menaxher i Projekteve-** e kemi në planifikim të ndërtimit të kanalizimit dhe do të rregullohet
**Kryetari** – prioritet për ndërtim të kanalizimit është ku ka më shumë shtëpi dhe do të shkojmë me rend.

**Selim Basholli - Samadrexh** – nga vërshimet kemi dëme.
**Kryetari** – nga vërshimet është zgjeruar lumi dhe do të pritet deri sa të ulet niveli i ujit që të mund të punohet.

**Besim Halili – Vushtrri** – kam disa kërkesa që na pengojnë si qytetar dhe na dëmtojnë shëndetin:
- Rrugët që të qojnë tek shkolla "Naim Frashëri" bllokohen për qarkullim për shkak të shitësve të drunjtëve
- Tek tregu i qytetit pas orës 21:00 aty bëjnë ndezje të mbeturinave kanaqe mbeturina të pulave etj që duhe të dal inspekcion ti kontrollon,
- Në rrugën "Nazmi Aliu" fabrika e qeseve të mbeturinave kundërmon erë të keqe,
- Në rrugën "Hamit Hyseni" afër market Korabi Show është një elevator i materialit që bënë pengesë pë qarkullimin e qytetarëve në atë rrugë,
- Kryqëzimi i rrugës "Bedri Pejani" –" Skenderbeu" a i plotëson nevojat e qytetarëve dhe a pengohe qarkullimi,
- Nuk ka ujë mbledhës nëpër qytet,
- Qyteti është i ndotur, të bëhet ndarja e mbeturinave në çdo shtëpi,
- A ka Komuna depo të baterive të hargjuara ku hidhen çdo vend në qytet?
- Tek Lumi "Tërstena" gjendet një hekurishte që hekurin e ndan e mbetjet e plastikës i hedh në lumë ju lutëm të ndërmerrni masa.

**Kryetari** - Tregu i druve do të largohet, do të bëhet shëtitore te Palestra te Ura e Gurit.
Sa i përket djegieve të mbeturinave inspektorati do të dal dhe do të përmirësohet gjendja, ndërsa për pastërti mbeturinat hiqen, pastrohen rrugët, kemi mbjellë lule ato ujiten si dhe drunjtë. Për ujëmbledhësit, do të bëjmë një projekt të veçantë si dhe do të merremi me çdo çështje që ke paraqit.

**Banor nga Dumnicë e Epërme** – rrugët e bllokuara nuk kem ujësjellës s'kemi kanalizim, kemi problem me përkthim të pronave .
**Kryetari** – Do të ketë investime kapitale për rrugë por edhe për ujësjellës për at pjesë në vitin e ardhshëm.
**Remzi Ahmeti** – sa i përket pronave duhet përmes Gjykatës procedurat ligjore për trashëgimi.

**Petrit Krasniqi – Shilovic-** nga vërshimet janë dëmtuar rrugët dhe as në ara nuk mundemi me hi për të i punuar.

**Kryetari** – E di që vërshimet kanë shkaktuar shumë dëme dhe vështirësi por do t ë mundohemi të ju dalim n ndihmë dhe rruga të bëhet e kalueshme.

**Naim Ibishi – Druar** – Në QMF në Druar mjeku nuk vjen sipas orarit të punës që ka por edhe infermierja shum pak qëndron aty nuk mundemi me marrë shërbime, detyrohemi të vijmë në Vushtrri ose në Maxhunaj, ku n Vushtrri nuk na japin shërbime se na thonë e keni qendrën atje, por edhe oborri i QMF-së është pa mirëmbajtu
**Nexhmedin Rashica – DSHPMS** – orari i mjekut dhe infermieres është nga ora 8:00 deri 14:00 ne kemi q komision për verifikim dhe ka qen aty, por ju duhet të bëni ankesë me shkrimë për kohën dhe datën kur ju nuk gjeni aty mjekun, dhe ne do të ndërmarrim masa.

**Xhemajl Bojku – Druar** - sa i përket ankesës për QMF për mjek dhe infermiere ashtu është ne jemi aty afër dh nuk respektohet orari i punës, neve në Vushtrri nuk na jepet shërbim si dhe oborri i është i pa mirëmbajtur.
**Kryetari** – Do të kontrollohen dhe do të jem me ju nuk do të lejoj të marrin pagë e mos të kryejnë shërbimet.

**Nazif Rexha – Dumnicë** – Pse një herë ka qenë njoftimi për bursa për infermier dhe pastaj është tërhequr.
**Kryetari-** Nuk ka bursa për të gjitha drejtimet sa i përket ati njoftimit është bërë një gabim, prioritet kanë drejtime deficitare që studentët të kenë interesim ku vijnë deri te puna më lehtë, nuk kemi mundësi buxhetore ma shumë.

**Esat Haradinaj – Stanofc i Epërm** – është mbyllur kanali nga reshjet e shiut dhe nga shtrurja e rrugës.
**Kryetari** – Nga reshjet ka shumë dëmtim por do të mundohemi ti rregullojmë.

**Takimi publik me qytetar përfundoi në 12:40**

**Procesmbajtësi- e**

**Besarta Muzaqi Feka**

**Kryetari i Komunës**

**Ferit Idrizi**

Republika e Kosovës

Komuna Vushtrri

## LISTA E PJESËMARRËSEVE NË TAKIMIN PUBLIK ME QYTETAR
## Më:30.06.2023

| Nr. | Emri Mbiemri | Numri i telefonit | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1. | Sadik Beka | 045/810-340 | |
| 2. | Musa Meholli | 044/213-360 | |
| 3. | Adil Beka | 044226834 | |
| 4. | Murteza Dallku | 044/367-330 | |
| 5. | Vesel [illegible] | 044 180 907 | |
| 6. | PETRIT KRASNIQI | 044 836 742 | |
| 7. | SEFEDIN BEHRAMI | 045 894 213 | |
| 8. | EMIN HASANI | 044 198-535 | |
| 9. | [illegible] Bokolli | 044-206-113 | |
| 10. | SELIM BASHOLLI | 044-602-190 | |
| 11. | Selim Ferati | 045-640999 | |
| 12. | [illegible] MIFTARI | 044-435-114 | |
| 13. | [illegible] HAFDARI | 044-213-282 | |
| 14. | Ibrahim Manoce | 044 384 097 | |
| 15. | [illegible] JADERI | 045-201-973 | |
| 16. | FEJZULLAH ZEQIRI | 044-309-061 | |
| 17. | BESIM HALILI | 049/610-771 | |
| 18. | [illegible] Haradinaj | 045 365-893 | |

Republika e Kosovës

Komuna Vushtrri

## LISTA E PJESËMARRËSEVE NË TAKIMIN PUBLIK ME QYTETAR
Më:30.06.2023

| Nr. | Emri Mbiemri | Numri i telefonit | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 19. | Rafet Haradinaj | 044-646-907 | |
| 20. | SABEDIN HAJREDINAJ | 044-106-654 | |
| 21. | GAZMEND SELMANI | 044.147-295 | |
| 22. | Besart Mustafa | 049240185 | |
| 23. | ESAT HAJREDINAJ | 045 898 393 | |
| 24. | FAIK PRONAJ | 044-384-183 | |
| 25. | Fehmi Shala | 044-157-144 | |
| 26. | Netire Muza | 044-148-71 | |
| 27. | Myrvete Zekolli | 044-722 474 | |
| 28. | REMZIJE ZEKAJ | 045-499-161 | |
| 29. | Nexhmane Krasniqi | 045-251-512 | |
| 30. | Makfire Begiri | 043-839993 | |
| 31. | Rimesa Begiri | 048-236-421 | |
| 32. | BURIM HETEMI | 049 889 700 | |
| 33. | Sami Mulli | 049-636366 | |
| 34. | Ismail Hasani | 044960363 | |
| 35. | Gëzim Saraci | 044 406 941 | |
| 36. | Visar Mexhuni | 044 635-528 | |
| 37. | XHEMAJL BOJK | 044/381115 | |

Republika e Kosovës

Komuna Vushtrri

## LISTA E PJESËMARRËSEVE NË TAKIMIN PUBLIK ME QYTETAR
## Më:30.06.2023

| Nr. | Emri Mbiemri | Numri i telefonit | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 38. | Hazim Ibishi | 044 644497 | |
| 39. | Behar Duraku | 049636868 | |
| 40. | Vehbi Mulliqi | / | |
| 41. | Mehmet Salihu | 049643038 | |
| 42. | RRAHIM HASANI | 049245434 | |
| 43. | Faik HASANI | 044324971 | |
| 44. | Nazif Rexhu | 044 294 176 | |
| 45. | Albiona Isa | 049/849-852 | |
| 46. | Mirjeta Duraku | 049497987 | |
| 47. | Donjetë Latifi | 044 106 214 | |
| 48. | Ekrem Merovci | 044423756 | |
| 49. | Fidane Hyseni | 711~ | |
| 50. | | | |
| 51. | | | |
| 52. | | | |
| 53. | | | |
| 54. | | | |
| 55. | | | |
| 56. | | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
K r y e t a r i

# R A P O R T

# PËR SITUATËN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE INVESTUESE PËR JANAR-QERSHOR 2023

Shtator 2023

H y r j e

Në këtë raport jemi bazuar në planifikimin që është bërë në këtë vit si për projektet prioritare ashtu edhe për punët dhe aktivitetet e qeverisë komunale për secilën drejtori dhe sektorë me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara me planifikimin që është bërë, planet e punës në secilën drejtori si dhe planin e punës së kuvendit në bazë të cilit kryetari i komunës ka për obligim që të raportoj para kuvendit së paku dy herë brenda një viti kalendarik.

Sa i përket projekteve kapitale, prioritet iu kemi dhënë atyre me vlerë më të madhe të cilat siç dihet kërkojnë kohë më të gjatë në procedurat e prokurimit publik. Deri tani janë nënshkruar kontrata me operatorë të ndryshëm ekonomik në vlerë rreth 4 milion euro dhe kemi filluar me implementimin e tyre në terren.

Bazuar në ecurinë e punëve që tani më janë duke u kryer besojmë se deri në fund të këtij viti do të i realizojmë të gjitha projektet që i kemi planifikuar.

Jemi angazhuar në finalizimin e punëve për furnizimin me ujë të pijes në të gjitha vendbanimet. Problemet na janë paraqitur në funksionalizimin e pompave të ujit në ato vendbanime ku nuk ka shtypje të mjaftuar për furnizim me ujë. Jemi të përkushtuar që këtë synim tonin ta realizojmë deri në fundin e këtij viti.

Sa i përket projekteve me donatorë vlen të përmendim marrëveshjet që i kemi nënshkruar për disa projekte të cilat janë në fazën e realizimit të tyre si: Islamic Relief me të cilën kemi arrijtë marrëveshje me bashkëfinancim ku nga buxheti i komunës dhe kësaj organizate janë subvencionuar 273 fermer me serra, me të njëjtin donator kemi lidhë marrëveshje për ofrim të shërbimeve shëndetësore për gratë lehona dhe persona të moshuar si dhe atyre me sëmundje të rënda përmes vizitave të drejtpërdrejta në terren, pastaj me "Ibër Lepencin" poashtu kemi lidhë marrëveshje për subvencionimin e bujqve me 50% për ujitje të kulturave bujqësore si dhe zgjerimin e rrjetit të ujitjes së tokave bujqësore, subvencionimin me 5 cent për litër qumësht të fermerëve, bletarët i kemi subvencionuar me 4 euro për koshere të bletëve, subvencionimin e fëmijëve të porsalindur, subvencione për shërim, pagesë të qirasë së banimit për familje të pa strehë etj.

Projekti i ndërtimit të tregut të gjelbër për shkak të ndryshimeve në projekt ende nuk ka filluar të realizohet. Është dashur që të lidhet aneks marrëveshje për ndryshim të vlerës së projektit si dhe është zgjatë afati i realizimit deri në vitin 2025. Deri te këto ndryshime të projektit ka ardhë për shkak se kemi konsideruar që ky treg duhet të ketë katin nëntokësor ku do të mund të shërbej për parkim të automjeteve me produktet të cilat do të shiten në treg.

Gjithashtu kemi subvencionuar apo thënë më mirë jemi në fazën e subvencionimit të organizatave joqeveritare përmes thirrjeve publike, subvencionimin e të rinjve përmes pagesës së trajnimeve në module të ndryshme, subvencionimin e personave për mësim për të rritur përmes aftësimit në qendrën për aftësim profesional Diakonia në Mitrovicë sikurse edhe mbështetjen e grave dhe vajzave përmes ndjekjes së trajnimeve në IADK në profile të ndryshme të cilat pajisen me certifikata si dhe iu është krijuar mundësia për hapje të bizneseve të tyre.

Sa i përket arsimit, kemi nda buxhet shtesë ku kemi rritë vlerën dhe numrin e përfituesve të bursave ku kemi nda 80 bursa për student që studijojnë brenda vendit dhe 10 bursa për studentët tanë jashtë vendit..

Në fushën e kulturës, Vushtrria në këtë vit bëhet me grup baleti pas nënshkrimit të marrëveshjes me Baletin Kombëtar të Kosovës, pritet të bëhet është bërë organizimi i manifestimit "Ditët e Diasporës" në muajin korrik dhe gusht, do të ndahen 70,000 € subvencione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit si dhe aktivitete tjera për të cilat bëhet fjalë në raportin e DKRS.

Për muajin korrik dhe gusht të këtij viti kemi parapa që në sektorin e gjendjes civile të punohet edhe ditëve të shtuna në mënyrë që të iu ofrohen kushte dhe mundësi bashkatdhetarëve tan të cilët vijnë për pushime që të pajisen me dokumente personale.

Gjithashtu kemi lanësuar "Platformën për Regjistrimin e Diaspores Vushtrriase" ku për herë të parë është krijuar mundësia e regjistrimit të qytetarëve tanë që gjinden në diasporë.

Janë bërë hapa të rëndësishëm për sa i përket eliminimit të pikave emergjente të lumenjve dhe proçkave në të cilat janë shkaktuar vërshime, është bërë zgjerimi dhe pastrimi i tyre ku janë evituar rreziqet për vërshime të tokave bujqësore, ekonomive familjare si dhe bizneseve private.

Edhe në muajt që jemi do të vazhdohet me pastrimin dhe zgjerimin e shtretërve të lumenjve dhe kanaleve kulluese atu ku ekziston mundësia e daljes nga shtrati i lumenjve gjatë reshjeve më të mëdha të shiut. Vërshimet që i kemi pasë në muajt e kaluar kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale cilat janë në fazën përfundimtare të vlerësimeve. Për këtë kemi angazhuar dy komisione të ndara, njëra për dëmet në bujqësi si dhe komisionin tjetër për dëmet në ekonomitë familjare dhe biznese. Te dëmet në bujqësi do të kemi listë të veçantë të familjeve të dëmtuara të cilën do ta dërgojmë në Ministrinë e Bujqësisë për mundësinë e kompensimit të atyre dëmeve, ndërsa për familjet e dëmtuara në shtëpitë e tyre të banimit si dhe bizneset do të ndahet fond i veçantë nga kuvendi varësisht nga mundësitë buxhetore për kompensim të dëmeve.

Janë siguruar pajisje për Njësinë e Zjarrfikësve në vlerë prej 24,000.00 €.

Kemi shënuar progres të jashtëzakonshëm në transparencën buxhetore, ku në raportin vjetor të Institutit GAP, jemi ngritur për tetë pozita. Në vitin 2022 jemi renditur në vendin e 9 me gjithsej 93.5 pikë.

Jemi të vetëdijshëm që kemi edhe shumë punë për të bërë por jemi të bindur poashtu që me një vullnet dhe angazhim të shtuar do të arrijmë që t'i realizojmë objektivat që ia kemi dhenë vetes kur kemi marrë përsipër ushtrimin e funksioneve si qeveri komunale.

Në vijim të këtij raporti do të i paraqesim në mënyrë të detajuar punët që janë kryer në secilën drejtori përkatësisht sektorë gjatë këtij gjashtëmujori.

**Buxhet dhe Financa**

Planifikimi i buxhetit për periudhën Janar – Qershor 2023

- Paga dhe mëditje .................................................. 6,744,776.47€
- Mallra dhe shërbime.............................................. 2,843,710.49€
- Shpenzime Komunale............................................. 287,500.00€
- Subvencione dhe transfero..................................... 651,413.00€
- Investime kapitale.................................................. 6,194,554.95€

Totali i planifikimit për kitë periudhë është........................................................ 16,721,954.91€

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Qershor 2023

- Paga dhe mëditje ................................................................. 5,937,749.94€
- Mallra dhe shërbime............................................................. 1,908,724.15€
- Shpenzime Komunale........................................................... 217,002.71€
- Subvencione dhe transfero.................................................... 205,635.4€
- Investime kapitale.................................................................. 46,566.01€

Totali i shpenzimeve................................................................................... 8,315,678.21 €

Realizimi i shpenzimeve në të gjitha fondet është .................................................. 50 %

**PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE**

| PËRSHKRIMI | KODI | PERIUDHA RAPORTUESE | | | VJETORE | | | | Viti I kaluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | BUXHETI I PLANIFIIKUAR | Shpenzimet të realizuar në PR | Përqindja e nuxhetit të alokuar | Buxheti I planifikuar për 2023 | Buxheti I mbetur për 2023 | Plani I reviduar 2023 | Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar | Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2022 |
| | | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Zyra e Kryetarit | 160 | 195,821.67 | 170,005.08 | 87% | 427,406.00 | 257,400.92 | 0.00 | 427,406.00 | 126,554.22 |
| Administrata dhe personeli | 163 | 327,905.66 | 215,150.14 | 66% | 539,052.93 | 323,902.79 | 0.00 | 539,052.93 | 149,751.67 |
| Inspektimet | 166 | 63,240.58 | 48,066.93 | 76% | 137,683.00 | 89,616.07 | 0.00 | 137,683.00 | 35,722.19 |
| Prokurimi | 167 | 25,871.78 | 21,761.78 | 84% | 55,360.93 | 33,599.15 | 0.00 | 55,360.93 | 11,998.76 |
| Zyra e Kuvendit Komunal | 169 | 141,264.99 | 128,181.62 | 91% | 142,264.99 | 14,083.37 | 0.00 | 142,264.99 | 67,809.16 |
| Buxheti dhe financat | 175 | 102,211.84 | 79,701.81 | 78% | 199,918.00 | 120,216.19 | 0.00 | 199,918.00 | 71,120.62 |
| Shërbimet publike, Mbrojtja civile dhe emergjenca | 180 | 3,657,523.09 | 1,117,284.47 | 31% | 5,146,510.16 | 4,029,225.69 | 0.00 | 5,146,510.16 | 847,640.28 |
| Zyra lokale e komuniteteve | 195 | 42,351.68 | 28,076.64 | 66% | 70,079.00 | 42,002.36 | 0.00 | 70,079.00 | 20,699.38 |
| Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural | 470 | 403,135.97 | 121,530.53 | 30% | 698,112.92 | 576,582.39 | 0.00 | 698,112.92 | 87,899.30 |
| Gjeodezi dhe Kadastër | 650 | 45,198.04 | 35,759.47 | 79% | 94,183.00 | 58,423.53 | 0.00 | 94,183.00 | 34,070.24 |
| Planifikimi urban dhe mjedisi | 660 | 2,283,451.87 | 34,037.88 | 1% | 3,224,044.70 | 3,190,006.82 | 0.00 | 3,224,044.70 | 45,765.84 |
| Shëndetësia primare | 730 | 1,929,578.20 | 1,119,296.23 | 58% | 3,363,645.64 | 2,244,349.41 | 0.00 | 3,363,645.64 | 1,064,412.98 |
| Shërbimet sociale rezidenciale | | 165,913.15 | 107,848.68 | 65% | 325,104.38 | 217,255.70 | 0.00 | | 87,573.03 |
| Kulturë, rini, sport | 850 | 321,214.34 | 104,671.12 | 33% | 529,165.65 | 424,494.53 | 0.00 | 529,165.65 | 180,164.82 |
| Arsimi | 920 | 7,017,272.05 | 4,984,305.83 | 71% | 10,045,384.59 | 5,061,078.76 | 0.00 | 10,045,384.59 | 4,012,871.96 |
| TOTALI | | 16,721,954.91 | 8,315,678.21 | 50% | 24,997,915.89 | 16,682,237.68 | 0.00 | 24,997,915.89 | 6,844,054.45 |

Sqarim:Përmbledhja e shpenzimeve sipas Drejtorive dhe kategorive ekonomike për periudhën Janar-Qershor 2023 është si vijon:
Duke u bazuar në planin buxhetor të drejtorive,buxheti I planifikuar është 16,721,954.91euro,Buxheti I realizuar arrin shumën 8,315,678.21euro Për periudhen Janr-Qershor 2023.Shprehur në përqindje për kit periudhë 50% është realizimi.

TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK

| | | Komuna :Vushtrri | Planifikimi mujor | Realizimi | Realizimi | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 644 | Janar-Qershor | Janar-Qershor | Janar-Qershor | % | % |
| | | Pershkrimi | 2023 | 2022 | 2023 | | |
| | | | 1 | 2 | 3 | 3:1 | 3:2 |
| Administrata | 1 | Admin. | 50,000.00 | *34,898.00* | *33,449.00* | 66.90 | 95.85 |
| | 2 | | | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Totali | | Administrat | 50,000.00 | 34,898.00 | 33,449.00 | 66.90 | 95.85 |
| | 4 | Taksat e firmave | 7,500.00 | 16,500.00 | 13,500.00 | 180.00 | 81.82 |
| | 5 | Tatimi në pron. | 576,072.00 | 461,762.91 | 804,258.54 | 139.61 | 174.17 |
| | 6 | | | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Totali | | Buxhet | 583,572.00 | 478,262.91 | 817,758.54 | 140.13 | 170.99 |
| Arsimi | 7 | Shitja.produ.bujqso. | | | | | #DIV/0! |
| | 8 | Participimi Q.Fëmi. | 30,000.00 | 23,632.00 | 38,165.00 | 127.22 | 161.50 |
| | 9 | Shkolla SHMT | 7,500.00 | 6,580.00 | 9,639.00 | 128.52 | 146.49 |
| | 10 | Shkolla SHMP | 7,000.00 | 9,660.00 | 7,810.00 | 111.57 | 80.85 |
| Totali | | Arsimi | 44,500.00 | 39,872.00 | 55,614.00 | 124.98 | 139.48 |
| | 12 | RDPP ,Dalja ne teren | 35,000.00 | 62,464.00 | 52,767.00 | 150.76 | 84.48 |
| | 16 | Qiraj nga objekti pub. | 11,500.00 | 2,155.00 | 6,607.10 | 57.45 | 306.59 |
| Totali | | Gjeodezi Kataster | 46,500.00 | 64,619.00 | 59,374.10 | 127.69 | 91.88 |
| Kultur .Rini.Sport | 17 | Palestra sportive | 500.00 | 48.00 | 240.00 | 48.00 | 500.00 |
| | 18 | Bibloteka M-.L.k-Sm | 250.00 | | | - | #DIV/0! |
| | 19 | Shtepia e Kultures | 500.00 | | | - | #DIV/0! |
| Totali | | Kultur | 1,250.00 | 48.00 | 240.00 | 19.20 | 500.00 |
| Sher.publi. | 20 | Ndalja e vet.rrugë | 1,000.00 | 2,867.80 | 650.00 | 65.00 | 22.67 |
| | | Regjistrmi I automjetev | 60,000.00 | 60,590.50 | 67,451.50 | 112.42 | 111.32 |
| | 21 | Taksat e Mbeturunave | 378,000.00 | 244,530.95 | 282,427.64 | 74.72 | 115.50 |
| Totali | | Sherbimet Publike | 439,000.00 | 307,989.25 | 350,529.14 | 79.85 | 113.81 |
| Prokurim | 22 | Tender | | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| | | Prokurimi | | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Ekonomi | 23 | Ndrim.tok.B. | 7,500.00 | 18,600.00 | 47,964.70 | 639.53 | 257.87 |
| | 24 | Leje pune | | 60.00 | | #DIV/0! | - |
| Totali | | Ekonomi | 7,500.00 | 18,660.00 | 47,964.70 | 639.53 | 257.05 |
| Totali | 25 | Particip.D.shënd. | 25,000.00 | 21,240.50 | 22,697.23 | 90.79 | 106.86 |
| | | Qendra.per pun.soci. | 1,000.00 | 1,665.00 | 1,830.00 | 103.24 | 109.91 |
| | | Shendetësi | 26,000.00 | 22,905.50 | 24,527.23 | 94.34 | 107.08 |
| | 26 | Donacion | | | | | |
| Drj.e Inspeksionit | 27 | Pranimet Teknike | 2,500.00 | 2,515.00 | 5,700.00 | 228.00 | 340.30 |
| | 28 | Gjobat e inspekcionit | 2,500.00 | 1,675.00 | 2,450.00 | 98.00 | 146.27 |
| | 29 | | | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Totali | | Inspeksioni | 5,000.00 | 4,190.00 | 8,150.00 | 163.00 | 163.00 |
| Urbanismit | 30 | Leje Ndertimi | 211,957.50 | 292,554.12 | 258,698.69 | 122.05 | 122.05 |
| | 31 | Leje mjedisore | 25,000.00 | 19,774.78 | 43,632.93 | 174.53 | 220.65 |
| | 32 | Legalizimi I Objekteve | 7,500.00 | 9,001.56 | 16,684.74 | 222.46 | 185.35 |
| | 33 | Rrenimi I objektit | | 156.24 | 668.64 | #DIV/0! | 427.96 |
| | 34 | Shf.prones publike | 2,500.00 | 5,164.20 | 620.00 | 24.80 | 12.01 |
| Totali | | Urbanismi | 246,957.50 | 326,650.90 | 320,305.00 | 129.70 | 98.06 |
| | 35 | Denimet e Policis | | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| | 36 | Denimet Gjykates | | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| | 37 | Gjobat e Pyjeve | | 250.00 | 1,521.40 | | |
| | 38 | Të hyrat tjera | | 29,873.00 | 5,649.20 | #DIV/0! | 18.91 |
| Totali | | | 1,450,279.50 | 1,328,218.56 | 1,725,082.31 | 118.95 | 129.88 |

**Sqarim:Të hyrat e planifikuara për periudhën Janar-Qershor 2023 janë 1,450,279.50euro.**

Të hyrat e realizuara për periudhën Janar-Qershor 2023 janë 1,725,082.31euro.

Shprehur në përqindje realizimi 29.88% më I madhë

Krahasuar me vitin paraprak për të njëten periudh 18.95% është më I madhë .

## Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Sektori i Ekonomisë.

Pasqyra tabelare të bizneseve të regjistruara ( aktive) gjatë periudhës 01.01. – 30.06.2023

| CODE | VEPRIMTARITË EKONOMIKE | Bizneset prej 01.01-30.06.2023 | % |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| A | **Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi** | 20 | 11.23 |
| B | **Minierat dhe guroret ( Industria nxjerrëse)** | | |
| C | **Industria përpunuese** | 8 | 4.50 |
| D<br>E | **Furnizimi me energji elektrike dhe ujë**<br>**Kanalizimi aktivitetet e menaxhimit dhe te trajtimit te mbeturinave** | 7 | 3.93 |
| F | **Ndërtimtaria** | 26 | 14.6 |
| G | **Treg.me shumicë dhe pakicë, riparimi i auto. dhe aparateve tjera të amvisërisë** | 32 | 17.98 |
| H | **Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit** | 11 | 6.18 |
| I | **Transporti dhe magazinimi**<br>**Informimi dhe komunikimi** | 4 | 2.24 |
| | **Aktivitetet financiare dhe të sigurimit** | | |
| K | **Aktivitetet e patundshmërisë**<br>**Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike,**<br>**shërbimet administrative dhe mbështetëse** | 23 | 12.93 |
| M | **Arsimi** | 7 | 3.93 |
| N | **Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale** | 23 | 12.93 |
| O | **Artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet tjera shërbyese** | 15 | 8.43 |
| P | **Aktivitetet e ekonomive familjare** | 2 | 1.12 |
| | **Gjithsej** | **178** | **100** |

Sektori i bujqësisë

_Projektet e realizuara gjatë vitit 2023 :

Ka filluar projekti i furnizimit të fermerëve të komunës tonë me serra me **275** copë me sipërfaqe **100m²**, projekt ky në bashkëfinancim me IRË-në me vlerë të përgjithshme **362,883.20** ku Komuna e Vushtrrisë participin me **180,360.00€**. Është projekt dy vjeçar.

Kemi pranua dokumentacionin e nevojshëm dhe regjistrimi e fermerëve ne sistemin LPS në kuadër të Thirrjes për pagesa direkte për litër qumësht për 6 mujorin e dytë të vitit 2022 si dhe për viçat në majmëri gjithsej **118** fermer.

Kemi shqyrtua kërkesat e fermerëve për dëmet e shkaktuara në bujqësi gjatë këtij 6 mujori, gjithsej **40** lëndë me vlerë **70,800.43€**.

Kemi pranua dokumentacionin e nevojshëm dhe regjistrimi e fermerëve ne sistemin LPS në kuadër të Thirrjes - Programi për pagesa direkte për vitin 2023-Subvencionimi i fermerëve të komunës së Vushtrrisë nga MBPZHR

Gjatë periudhës së aplikimit të fermerëve për subvencione sipas thirrjes së MBPZHR të datës 28.02.2023 kanë aplikuar gjithsej **692** fermerë të cilët kanë aplikuar në pagesa direkte. Lëndët janë pranuar nga ana e AZHB-së, janë trajtuar- kontrolluar tani pritet vetëm kontroll nga tereni dhe ekzekutimi i pagesave.

Subvencionimi i fermerëve nga buxheti i komunës,**108** fermerë në vlerë prej **73,534.45€.**

Vendime për shndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore.

Gjithsejtë vendime të lëshuara **30** vendime me vlerë te përgjithshme **47,964.70 €**

Sektori i Pylltaris

| Nr. | PËRMBAJTJA | SASIA | VREJTJE |
|---|---|---|---|
| 1. | Kërkesa të paraqitura për leje-prerje | 21 | |
| 2. | Kërkesa të kryera | 4 | |
| 3. | Damkosje ,dru zjarri | 149.50m³ | |
| 4. | Vulosje,dru zjarri | 22 flp=45.50m³ | |
| 5. | Fletëpagesa p.private | 1copa = 52.50€ | |
| 6. | Fletëpagesa-shitje nga depoja | 0copa=0m³=0€ | |
| 7. | Konfiskime | 1 copa= 1.60m3 | |
| 8. | Zjarre në pyje | | |
| 9. | Fletëparaqitje kundërvajtje | 23=38.52m³=5648.63€ | |
| 10. | Fletëparaqitje penale | 28=99.20m³=13722.05€ | |
| 11. | Kontrolle terreneve | 61 | |

## Administratë

Drejtoria e Administratës ka vazhduar me punën ekipore në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Vushtrrisë dhe më gjerë, e poashtu në përmirësimin e kushteve të punës për të gjithë punëtorët e administratës komunale. Bazuar ne këtë, në përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e hapësirave të përshtatshme për punë dhe shërbim sa më të mirë ndaj qytetarëve , vitin e kaluar kemi bërë ndërtimin e sallës në katin e dytë të komunës, dhe këtë vit kemi iniciuar procedurat për furnizim me mikrofon për atë sallë në mënyre që të mbahen takime te ndryshme pune.
Është bërë inicimi i procedurave per fazën e dytë të rregullimit të ngrohjes/ftohjes, është bërë inicimi i procedurës për furnizim dhe montim të tabelës së shpalljes, inicimi i procedurës për furnizim dhe

montim të dyerve kryesore të komunës, inicimi i procedurës për servisim dhe mirëmbajtje të aparateve kundër zjarrit dhe gjeneratorit.

Është iniciuar procedura dhe janë pajisur me kartela identifikuese 25 kryetarët e këshillave lokalë. Procedurat e furnizimit te drejtorisë me material shpenzues zyrtar, furnizimi me certifikata.
Zyrtarët e drejtorisë së Administratës në vazhdimësi janë pjesë e komisioneve për vlerësim të aktiviteteve të prokurimit e poashtu në mbikëqyrje të kontratave të ndryshme, komisione per pranim dhe të tjera.

Si drejtori kemi bërë përgatitjet për pritjen e bashkatdhetarëve gjatë muajve të verës ku kërkesat për certifikata dhe për shërbime të tjera nga gjendja civile janë më të mëdha, andaj me vendim të kryetarit të komunës kemi filluar që të punojmë edhe të shtunave prej orës 10:00 deri në ora 14:00 dhe kemi caktuar 3 sportele të veçanta vetëm për bashkatdhetarët me qëllim që të krijojmë kushte për trajtim sa me të mirë dhe për një shërbim sa më të shpejtë për mërgimtaret e komunës sonë.

Trendi i ngritjes së efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve më të mira, është në ngritje duke ju falënderuar angazhimit dhe punës rutinore që bëjnë gjithë zyrtarët e drejtorisë.

Sektori i Gjendjes Civile

Certifikatat dhe dokumentet e lëshuara gjatë periudhës janar-qershor 2023

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të lindjes | 7 |
| 2. | Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të vdekjes | 12 |
| 2. | Vendime për ndërrimin e emrit personal | 8 |
| 3. | Vendime për korrigjime të të dhënave personale në RQ | 22 |
| 4. | Vendime për korrigjimin e të dhënave në regjistra fizik | 45 |
| 5. | Vendime për anulimin e faktit të lindjes | 6 |
| 6. | Dëshmi të vdekjes | 108 |
| 7. | Lajmërime dhe ç'lajmërime të adresës së vendbanimit | 239 |
| 8. | Vendime për korrigjimin e Akteve të lindjes, | 2 |
| 9. | Vendime për korrigjimin e Akteve të vdekjes | 6 |
| 9. | Vendime për korrigjimin e Akteve të martesës | 4 |
| 10. | Aplikime për natyralizim(fitim të shtetësisë) | 6 |
| 11. | Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim | 28 |
| 12. | Aplikime për rikthimin e shtetësisë së Kosovës | 5 |
| 13. | Aplikime për fitimin e shtetësisë me martesë | 5 |
| | Gjithsej regjistrime të bëra | **503** |

**Numri i dokumenteve të lëshuara:**

| **Nr.** | **Përshkrimi** | **Lëshuara** |
|---|---|---|
| 1. | Ekstrakt i lindjes | 14265 |
| 2. | Certifikata të lindjes | 7973 |
| 3. | Certifikata të martesës | 4145 |

| | | |
|---|---|---|
| 4. | Certifikata të vdekjes | 1384 |
| 5. | Certifikata të Statusit martesor | 428 |
| 6. | Certifikata të shtetësisë | 131 |
| 7. | Certifikata familjare | 4807 |
| 8. | Certifikata të vendbanimit | 2374 |
| 9. | Vërtetim nga arkivi | 296 |
| Gjithsej | | **35803** |

**Regjistrime në Regjistrat e Gjendjes civile**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Regjistrime të lindjes | 80 |
| 2. | Martesa | 310 |
| 3. | Regjistrime të vdekjes | 182 |
| 4. | Regjistrime të Shtetësisë | 9 |
| 5. | Regjistrime të lindjes jashtë shtetit | 62 |
| 6. | Regjistrime të martesës jashtë shtetit | 22 |
| 7. | Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit | 23 |
| 9. | Shkurorëzime | 52 |
| Gjithsej regjistrime | | **740** |

Ne këtë periudhë janë verifikuar **178** qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa qe nga fillimi i sistemit te ri me **19.02.2013** janë te verifikuar apo te regjistruar ne sistemin e gjendjes civile **101423** qytetar të komunës së Vushtrrisë.
Në kuadër të organeve të administratës janë paraqitur gjithsej 29 133 kërkesa, prej të cilave janë:

| **Nr.** | **Përshkrimi** | **Nr. kërkesave** |
|---|---|---|
| 1 | Drejtoria për Administratë | 19508 |
| 2 | Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër | 3759 |
| 3 | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 1444 |
| 4 | Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural | 295 |
| 5 | Drejtoria për Shërbime Publike | 432 |
| 6 | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 1004 |
| 7 | Drejtoria për Arsim | 322 |
| 8 | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit | 395 |
| 9 | Drejtoria për Inspektime | 268 |
| 10 | Personeli | 844 |
| 11 | Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim | 451 |
| 12 | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | 141 |
| 13 | Zyra ligjore | 14 |
| 14 | Kryetari i Komunës | 199 |
| 15 | Drejtoria e Prokurimit | 7 |

| | | |
|---|---|---|
| 16 | Kuvendi i Komunës | 39 |
| 17 | Zyra lokale e komuniteteve | 9 |
| 18 | Njësia e auditimit të brendshëm | 2 |
| | Gjithsejtë | 29.133 |

**Arsimi**

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri ka menaxhuar mbarëvajtjen e procesit mësimor gjithnjë sipas kalendarit të vitit shkollor 2022/23.

Gjysmëvjetori i dytë ka filluar më 6 shkurt 2023 ndërsa ka përfunduar për klasën 12 –të ( maturantë) me datë: 15.06.2023, për klasat 9, 10, 11, më datë: 27.06.2023, për klasat parafillor dhe 1-8 –të më: 30.06.2023.

Informata të përgjithshme:

| | |
|---|---|
| **Numri i përgjithshëm i institucioneve edukativo-arsimore** | **36** |
| **Numri i punonjësve** | 1141 |
| **Numri i nxënësve në gjysëmvjetorin e dytë** | 13151 |
| **Numri i paraleleve** | 651 |
| **Numri i nxënësve** | Niveli 0: 1018 nx.<br>Niveli 1: (1-5) 5243 nx.<br>Niveli 2: (6-9) 4062 nx.<br>Niveli 3: ( 10-12) 2828 nx.[1] |

Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022/23, ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara, të cilat janë paraqitur në këtë informatë. Këto zhvillime u bënë duke u ndarë detyrat me kohë më qëllim të përgjegjësisë dhe llogaridhënies reciproke.
Gjatë kësaj kohe u realizuan këto aktivitete:

I. Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat

- Janë zhvilluar monitorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë, e që në objektiv kryesor kishin: fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë;
- Takime të rregullta me Inspektorët Regjional të Arsimit;
- Takime të rregullta me MASHTI;
- Takime të rregullta me KFORIN slloven;
- Takime të rregullta të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiumi për Arsim;
- Ju është vlerësuar përformanca 3 drejtorëve të shkollave;
- Nga ekipi komunal për vlerësimin e nxënësve janë vlerësuar 4 nxënës si dhe rivlerësuar 6 nxënës me nevoja të veçanta arsimore;
- Në protokollin e hyrjes janë regjistruar 233 shkresa;
- Në protokollin daljes janë regjistruar 452 shkresa:
- Në intranet janë regjistruara 307 dhe janë shqyrtuar 307;
- Në e-depo u regjistruan 56 hyrje dhe 56 dalje;

[1] Për t'u konfirmuar pasi të mbyllen të dhënat në SMIA.

- Kontrata të menaxhuara nga zyrtarët e DKA: kontrata për furnizim me material për mirëmbajtje të objekteve, kontrata për furnizim me inventarë zyrtar shkollor, kontrata për furnizim me letër, kontrata për furnizim me shujta ditore për klasat 0-5, kontrata për furnizim me lëndë djegëse ( dru) në shkolla, kontrata e transportit të nxënësve, kontrata për internet; kontrata për material zyrtar;
- Janë furnizuar me kifle nxënësit nga klasa para fillor deri në klasën e V-të; deri në muajin prill;
- Në të gjitha shkollat u shënua dita e internetit të sigurt;
- Është organizuar java e dyerve të hapura, ku nxënësit e klasave të IX-ta janë pritur nga shkollat profesionale. Të gjithë nxënësve ju është siguruar transporti;
- U shënua 22 maji Dita Botërore me eko-klubet e shkollave si dhe me OJQ-Biodiversitetit, si dhe me ligjëratë të prof.dr.Halil Ibrahimi;
- Pjesëmarrje në ceremoninë përmbyllëse të projektit të realizuar nga LuxDev në SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri;
- Pjesëmarrje e nxënësve në FSK për pjesëmarrje në projektin "Edukimi për Siguri" ;
- U certifikuan dy eko-klubeve të shkollave të mesme nga organizata CEDE;
- U mbajt program artistik për nderë të 7 marsit- Ditës së mësuesit;
- Për ndër të kontributit në arsim janë vendosur pllaka të mirënjohjes për shtëpitë shkolla të viteve të 90-ta;
- Vizita të rregullta në qendrën arsimore të Komunitetit VORAE në Prilluzhë;
- Gjatë këtij gjysmëvejtorit janë punësuar: 5 psikologë në shkolla, 10 edukatore, 2 mësimdhënës lëndor dhe 4 punëtorë teknik,
- SHMP "Bahri Haxha" është përfituese e Grantit nga fondi rajonal i sfidave RCF në vlerën 410.000 euro;
- Ka filluar meremetimi i shkollave sipas LOT1, LOT-2, LOT-3 dhe LOT4,LOT-1: SHFMU "12 Qershori" në Mihaliq, Gjimnazi "Eqrem Çabej", SHFMU "Latif Berisha" në Doberllukë, SHFMU "Liria Në Stroc, LOT-2:SHFMU "Martirët" në Reznik, SHFMU "Migjeni" në Stanoc, dhe SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri, LOT-3: SHFMU "Adem Voca" në Pasomë, SHF "Ali Kelmendi" në Studime, SHFMU "Lumni Surdulli" në Samadrexhë, SHFMU "Rilindja" në Maxhunaj LOT-4: SHFMU "Enver Hadri" në Smrekonicë, SHFMU në Lummadh;
- Transporti i nxënësve është realizuar në 35 vija udhëtuese;
- Janë shpallur bursat për studentë: 65 bursa brenda vendi me vlerë 600.00 euro, 15 bursa jashtë vendit me vlerë 800.00 euro;
- Zyrtarë të DKA-së morën pjesë në trajnimin për vlerësim të tenderëve ekonomikisht më të favorshëm organizuar USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës, zbatuar nga DAI Global LLC;
- U mbajtë punëtoria njëditore me ekipet parandalimin e braktisjes së nxënësve të shkollave të mesme dhe të ulëta, organizuar nga ECMI- Kosova, UNICEF dhe MASHTI;

## II. Garat, aktivitetet dhe të arriturat

- Më datë: 11.02.2023, u mbajtën garat në lëndën e fizikës organizuar nga Shoqata Kosovare e Fizikës në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit si dhe me shkollat e komunës së Vushtrrisë për klasat: IX, X, XI, XII. Në këto gara morën pjesë 16 shkolla të nivelit 2 (shkolla të mesme të ulëta) me gjithsej: 16 nxënës dhe 3 shkollat të nivelit 3 ( shkollat e mesme të larta) më gjithsej: 25 nxënës. Tri vendet e para për: SHFMU- Nedakoc, SHFMU-Pestova dhe SHFMU "Emin Duraku", dhe ndërsa vendin e parë në shkollat e mesme të larta e zuri Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri;
- Pjesëmarrje në ekspozitë të organizuar nga MASHTI, për nderë të 17 shkurtit në të cilën ekspozitë mori pjesë edhe nxënësja nga SHMP "Bahri Haxha" Vushtrri Fazile Murarti, në këtë ekspozitë morën pjesë nxënës nga Kosova dhe Shqipëria;
- Pjesëmarrje të nxënësve të klasave të VII-ta për në Shkollën Dimërore e Skijimit në Brezovicë SHFMU "Dëshmorët" Zhilivodë, SHFMU "Jusuf Gërvalla" Dumnicë e Poshtme, SHFMU "Bajram Curri' Dumnicë e M. gjithsej 22 nxënës, ku qëndruan 7 ditë;

- Gjimnazi "Eqrem Çabej" është përzgjedhur një ndër e para në komuna të Republikës së Kosovës nga KEC dhe Ipko Foundation projekti AADA. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është: Të fuqizojë komunitetet shkollore për të mbrojtur grupet e cenueshme nga diskriminimi përmes edukimit, ndërmjetësimit dhe zhvillimit të aftësive ndërkulturore;
- Më 25 shkurt 2023, pjesëmarrje në garat shtetërore të lëndës së Fizikës në Prizren me nxënës të: SHFMU "Emin Duraku", SHFMU- Pestova dhe SHFMU- Nedakoc dhe Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri. Ndërsa nxënësja e Gjimnazit " Eqrem Çabej" Vushtrri, Tuana Grabvoci ka prezantuar projektin me Robot, bazuar ne ligjet e Paskalit dhe Arkimedit para gjithë garuesve;
- Për nderë të "Festave të Marsit", me datë: 06.03.2023 u mbajtë gara në ese;
- Vendin e parë e fitoi Anisa Berisha, nxënëse e SHFMU "Enver Hadri" Smrekonicë;
- Vendin e dytë e fitoi Lerart Krasniqi, nxënës i SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri;
- Vendin e tretë e fitoi Leonita Sadiku, nxënëse e SHFMU "7 Marsi" Bukosh;
- Nga nxënësit e Gjimnazit "Eqrem Çabej" u organizua manifestimi i 7 marsit- ditës së mësuesit;
- Për nderë të "Festave të Marsit", më datë: 07.03.2023 në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" Vushtrri u organizua ekspozitë nga nxënësit e Gjimnazit;
- Për nderë të "Festave të Marsit", më datë: 08.03.2023 u organizua loja në Shah për nxënësit e klasës 1-5. Vendin e parë në të dy kategoritë e fituan nxënësit e kl.V-1 të SHF "Mustafë Venhari" Vushtrri,
- Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri, përfitoj projektin "Veprimi Kundër Diskriminimit për të gjithë", i cili do të zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në partneritet me Ipko Foundation (IF), i financuar nga Bashkimi Evropian. E cila marrëveshje bashkëpunimi u nënshkrua me datë:10.03.2023 në Europe House –Prishtinë;
- Në garat e skijimit me shkollat përfaqësuese në Brezovicë; nxënësit e SHFMU"Jusuf Gërvalla" Dumnicë morën vendin e dytë në garat regjionale kategoria meshkuj, ndërsa vendin e tretë vajza e SHFMU "Bajram Curri" Dumnicë e M.
- Nxënësja e SHFU "Hajruallah Shala"Akrashticë në garat për ese zuri vendin e tretë nx. Armelinda Shala, këto gara u mbajtën në gjimnazin "Hasan Nahi" Lipjan;
- Me 16.03.2023 u mbajtë gara Ndërkombëtare "Kangaroo" në Gjimnazin "Eqrem Çabej" Vushtrri;
- Instituti Pedagogjik i Kosovës me kërkesë të Ministrisë së Arsimit, ka realizuar hulumtimin për dhunën në familje ndaj nxënësve/fëmijëve në dy shkollat e komunës së Vushtrrisë SHMU-2 Vushtrri, dhe SHFMU "Liria" Stroc;
- Bashkë me Gjimnazin "Eqrem Çabej" Vushtrri, organizuam manifestimin e dëshmorit Skerdilajd Llagami – Komandant Shpendi;
- U mbajtë testi të ICLIS : 18 qershor dhe 19 qershor për shkollat ; SHMU – 2, SHMU – 1, Adem Voca, Lumadh, Hajrullah Shala, Enver Hadri Rilindja;
- U mbajtë testim TIMSS me klasat e 4-ta : SHF "Ali Kelmendi", SHF "Mustafë Venhari'', SHFMU "Liria" , SHFMU "12 qershori";
- Vizita e përfaqësuesve suedez "projekti MIS 2" në institucioneve parashkollore;
- Me datë: 27,28 prill 2023, një grup nxënës të shkollave të mesme vizituan panairin e punës në Prishtinë për dy ditë;
- U mbajt Panairi i shkencës në gjimnaz më: 04.05.2023;
- U mbajt Panairi i Këshillit Rinor të Nxënësve të SHFMU "Liria" Stroc organizuar nga GIZ.;
- Kolegji IBC-M për mbajti sesione informuese për nxënës të klasave të IX-ta;
- Green Art Center Prishtina, në kuadër të projektit "Green Educational Program – Green Clubs", mbështetur nga GIZ Kosova organizoi garat për 30 Shkolla në dhjetë komuna me tematikën " Mendo Gjelbër". Ndërsa në këtë projekt SHFMU "Hajrullah Shala'' ka fituar vendin e tretë në nivel vendi.
- Më datë: 11.05.2023 dhe më 12.05.2023, u mbajtën garat e diturisë për klasat e XII-ta në dy lëndë shkencore: Biologji dhe Kimi;

- Është realizuar gara e diturisë për klasat e IX-ta, renditja e shkollave: Vendin e parë: SHFMU "Enver Hadri" Smrekonicë, Vendin e dytë: SHFMU "Adem Voca" Pasomë, Vendin e tretë: SHFMU " Hajrullah Shala" Akrashticë;
- Më datë 14, 15 maj u mbajt garat në lëndën e kimisë dhe biologjisë në Gjimnazin "Eqrem Çabej" Vushtrri;
- Në garën Transformimi shoqëror inovativ në Kosovë organizuar nga KEC, DOKUFEST DHE AMBASADA E HOLANDËS SHFMU "Abdyl Frashëri" Druar ka zënë vendin e parë në nivel vendi;
- Në festivalin rajonal të këngëve korale me moton "I këndojmë atdheut në ditën e lirisë" në Mitrovicë SHMU-2 Vushtrri ka zënë vendin e dytë;

III. Testi i maturës 2023

Në komunën e Vushtrrisë më 24 qershor u mbajt me sukses testi i maturës, një pikë shumë e rëndësishme në rrugëtimin arsimor të nxënësve të shkollave të mesme. Në test morern pjesë tre institucioneve e arsimit të mesëm të lartë: Gjimnazi "Eqrem Çabej", SH.M.T. "Lutfi Musiqi", dhe SH.M.P. "Bahri Haxha". Ky raport paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të procesit të provimit, duke theksuar mungesën e ndonjë parregullsie dhe rezultatet e përgjithshme të arritura.

Administrimi dhe Transparenca e Provimit të Maturës

Administrimi i provimit të maturës ishte planifikuar dhe zbatuar me përpikëri për të garantuar drejtësi, transparencë dhe respektim të udhëzimeve të përcaktuara. Janë zbatuar masa për të ruajtur integritetin e procesit të provimit. U morën të gjitha masat e nevojshme për të krijuar një mjedis të favorshëm për vlerësim të ndershëm, duke mundësuar të demonstrojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre pa ndikim apo shpërqëndrim.

Testi i maturës u mbajt në këto qendra:

| Qendra | Nr. i nxënësve |
|---|---|
| Qendra 1: Gjimnazi "Eqrem Çabej" 1 | 144 |
| Qendra 2: Gjimnazi "Eqrem Çabej" 2 | 124 |
| Qendra 3: SHMT "Lutfi Musiqi" | 133 |
| Qendra 4: SHMP "Bahri Haxha" | 152 |
| Qendra 5: SHMP "Bahri Haxha" dhe SHMT "Lutfi Musiqi" | 77 |
| Qendra 6: SHMP "Bahri Haxha" 2 | 140 |

Provimi i maturës ka vijuar pa probleme, falë përpjekjeve të përbashkëta të institucioneve arsimore dhe mbështetjes së dhënë nga aktorët përkatës. Gjatë gjithë ditës së testit, një ekip profesional dhe i përkushtuar i mbikëqyrësve dhe administratorëve siguroi kryerjen e duhur të provimit, duke mbrojtur interesat e studentëve pjesëmarrës.

Nxënësit iu nënshtruan provimit në katër lëndë me nga 25 poena maksimal. Nga to, tre ishin lëndë bazike: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze dhe Matematikë si dhe një ishte lëndë zgjedhore sipas listës së lëndëve të ofruar nga MASHT.

Përmbledhje e rezultateve të testit

Rezultatet e provimit të maturës për vitin akademik 2023 nxjerrin në pah ndryshime të dukshme në performancën e shkollave pjesëmarrëse. Gjimnazi "Eqrem Çabej" doli me rezultate të jashtëzakonshme, pasi 93% e nxënësve të tyre e kaluan me sukses provimin. Në të kundërt, SH.M.T. "Lutfi Musiqi" dhe SH.M.P. "Bahri Haxha" regjistroi kalueshmëri afër 40%, duke nxjerrë në pah fusha që kërkojnë vëmendje dhe përmirësim të mëtejshëm.

Rezultatet e testit të maturës

Kalueshmëria në testin e maturës e shkëlqyeshme për Gjimnazin 93.28 %. Kalueshmëria për Shkollën e Mesme Profesionale "Bahri Haxha" dhe Shkollën e Mesme Teknike "Lufti Musiqi" ishte 37,5% përkatësisht 36,5%.

Ndonëse Ministria ka ndarë vetëm kopjet fizike të rezultateve, DKA ka ndërtuar databazën për të bërë analizën e rezultateve të testit të maturës edhe për shkollat pjesëmarrëse por edhe për lëndët bazike dhe zgjedhore, secilën veç e veç. Në vazhdim po paraqesim rezultatet e tre shkollave në lëndët bazë.




*Figura 1. Mesatarja e pikëve në lëndët bazë*

Këto të dhëna përfaqësojnë pikët mesatare në tri lëndë (Gjuhë Shqipe, Gjuhë Angleze dhe Matematikë) për tri institucione të ndryshme arsimore: Gjimnazi Eqrem Çabej, SHMP Bahri Haxha dhe SHMT Lutfi Musiqi.

Le të zbërthejmë të dhënat për secilin institucion:

Gjimnazi Eqrem Çabej:
- Gjuhë shqipe: Pikët mesatare në këtë lëndë për Gjimnazi Eqrem Çabej ishin 15.25.
- Gjuhë angleze: Pikët mesatare në këtë lëndë për Gjimnazi Eqrem Çabej ishin 16.42.
- Matematikë. Pikët mesatare në këtë lëndë për Gjimnazi Eqrem Çabej ishin 8.25.

SHMP Bahri Haxha:
- Gjuhë shqipe: Pikët mesatare në këtë lëndë për SHMP Bahri Haxha ishin 12.25.
- Gjuhë angleze: Pikët mesatare në këtë lëndë për SHMP Bahri Haxha ishin 9.44.
- Matematikë: Pikët mesatare në këtë lëndë për SHMP Bahri Haxha ishin 6.34.

**SHMT Lutfi Musiqi:**
- Gjuhë shqipe: Pikët mesatare në këtë lëndë për SHMT Lutfi Musiqi ishin 11.24.
- Gjuhë angleze: Pikët mesatare në këtë lëndë për SHMT Lutfi Musiqi ishin 9.48.
- Matematikë: Pikët mesatare në këtë lëndë për SHMT Lutfi Musiqi ishin 6.12.

Këto të dhëna japin njohuri për performancën mesatare të nxënësve në çdo lëndë në institucionet arsimore përkatëse.

Rezultatet e lëndëve zgjedhore

Bazuar në Udhëzuesin e MASHT, lëndët zgjedhore në dispozicion ishin:
- Fizikë
- Kimi
- Biologji
- Informatikë

75% e nxënësve zgjodhën ose Informatikën ose Ekonominë me ndërmarrësi si lëndë zgjedhore!

- Gjeografi
- Histori
- Sociologji
- Psikologji
- Ekonomi me ndërmarrësi
- Edukatë qytetare
- Histori e artit
- Teori e muzikës dhe harmoni

Nxënësit e Gjimnazit në një shumicë prej afro 60% zgjodhën Informatikën si lëndë zgjedhore ndërsa nxënësit e shkollave "Lutfi Musiqi" dhe "Bahri Haxha" zgjodhën lëndën Ekonomi me Ndërmarrësi në një përqindje prej 67%.

| **Mesatarja e pikëve në lëndët zgjedhore** | | | |
|---|---|---|---|
| | Gjimnazi "Eqrem Çabej" | SHMP "Bahri Haxha" | SHMT "Lutfi Musiqi" |
| Edukatë qytetare | 11,97 | 10,47 | 8,06 |
| Informatikë | 16,33 | 8,43 | 10,49 |
| Psikologji | 9,05 | - | - |
| Sociologji | 10,75 | 4 | - |
| Histori | 16 | - | - |
| Kimi | 11,83 | 6,35 | - |
| Fizikë | 18 | - | - |
| Gjeografi | 12,75 | - | - |
| Histori e Artit | 8 | - | - |
| Ekonomi me ndërmarrësi | - | 9,24 | 8,62 |
| Biologji | 12,93 | 5 | - |

Kemi analizuar gjithashtu pikët mesatare të nxënësve që e kaluan testin dhe atyre që nuk e kaluan. Kjo sepse, duam të shohim devijimin nga pragu i kalueshmërisë prej 40 pikëve për të tre shkollat. Ajo që vërejtëm, veçanërisht tek Gjimnazi, ishte që mesatarisht, ata që nuk e kaluan testin, ishin shumë afër kalimit prej përafërsisht 6 pikëve në mesatare.




Figura 2. Mesatarja e pikëve të nxënësve që kaluan testin dhe atyre që nuk e kaluan

Duke analizuar edhe informata të tjera që na japin rezultatet e testit të maturës (korrelacioni në mes të suksesit në lëndë bazë dhe rezultatit të përgjithshëm, sa është numri i nxënësve me variacione të theksuara në mes rezultatit në lëndë të caktuara, nëse paralele të caktuara kanë shënuar rezultat theksueshëm ndryshe nga të tjerat etj), DKA do të ndërtoj një pasqyrë të plotë të rezultatit të testit të maturës. Më pas, një listë rekomandimesh do të nxirret për secilën shkollë në lidhje me hapat që duhen ndërmarrë në vitin e ardhshëm shkollor që të ketë përmirësim në fushat dhe lëndët e caktuara. Këto mund të përfshijnë orë plotësuese, punëtori të ndryshme brenda shkollave, ushtrime të familjarizimit me formatin e testit etj.

Testi i Arritshmërisë u përbë nga 9 lëndë dhe gjithsej 200 kërkesa (pyetje, detyra). Drejtoria Komunale për Arsim për herë të parë ka digjitalizuar dhe përpunuar të dhënat e testit të arritshmërisë dhe ka nxjerrë analiza statistikore të cilat do të jenë shumë të dobishme për Drejtorinë dhe shkollat e komunës sonë.

Nr. i kërkesave

1. Gjuhë shqipe 35 pyetje
2. Gjuhë angleze 15 pyetje
3. Histori 25 pyetje
4. Gjeografi 25 pyetje
5. Matematikë 35 pyetje
6. Informatikë 15 pyetje
7. Fizikë 17 pyetje
8. Kimi 16 pyetje
9. Biologji 17 pyetje

Rezultatet e testit . Testi i Arritshmërisë nxori në dukje një rezultat të mirë të shkollave të Vushtrrisë. Pikët mesatare të të gjithë nxënësve ishin 99.93 pikë, ndërsa 49.59% e nxënësve arritën rezultat prej 100 e më shumë poenave. Kjo paraqet një rritje nga viti 2022 ku % e pikëve 100 apo mbi 100 ishte 44.59%. Ne konsiderojmë që një faktorë ndikues pozitiv janë garat komunale ku si rezultat i organizimit të tyre, 29 shkolla dhe rreth 150 nxënës janë përfshirë drejtpërdrejtë në to.

Në lëndë të ndryshme % e saktësisë varion. Në tabelën në vazhdim është pasqyruar përqindja e saktësisë së nxënësve në përgjigje e ndarë sipas lëndëve. Kjo është kalkuluar duke marrë për bazë numrin e pyetjeve për secilën lëndë dhe % e përgjigjeve të sakta të dhëna për to.

| LËNDA | Mesatarja e saktësisë në % |
|---|---|
| GJ. SHQIPE | 62.58 |
| GJ. ANGL. | 61.61 |
| HISTORI | 54.40 |
| GJEOGRAFI | 46.52 |
| MATEMATIKË | 41.29 |
| INFORMATIKË | 50.51 |
| FIZIKË | 40.28 |
| KIMI | 40.78 |
| BIOLOGJI | 47.93 |

Në nivel të komunës, shumë nxënës mbërritën pikë mbi 150. Në vazhdim janë paraqitur dhjetë nxënësit me performancën më të mirë në testin e arritshmërisë.

| SHKOLLA | EMRI | PARALELJA | GJ. SHQIPE | GJ. ANGL. | HISTORI | GJEOGRAFI | MATEMATIKË | INFORMATIKË | FIZIKË | KIMI | BIOLOGJI | TOTAL |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Bahri Kuqi' | VESA BERISHA | 1 | 33 | 14 | 23 | 21 | 33.0 | 12.0 | 15.0 | 15.0 | 15.0 | 181 |
| Bahri Kuqi' | ERDINA MORINA | 1 | 33 | 14 | 23 | 19 | 33.0 | 13.0 | 15.0 | 14.0 | 16.0 | 180 |
| SHMU-2' | REDON HAJRIZI | 6 | 31 | 14 | 23 | 24 | 29.0 | 12.0 | 13.0 | 16.0 | 12.0 | 174 |
| Bahri Kuqi' | LEARTA PLLANA | 1 | 31 | 13 | 21 | 20 | 33.0 | 12.0 | 14.0 | 16.0 | 14.0 | 174 |
| Rilindja' | ELSA AZEMI | 1 | 26 | 12 | 22 | 21 | 31.0 | 11.0 | 14.0 | 16.0 | 16.0 | 169 |
| Pestova | ARVANIT SADIKU | 1 | 34 | 15 | 22 | 21 | 26.0 | 12.0 | 13.0 | 11.0 | 14.0 | 168 |
| Bahri Kuqi' | VIONA MORINA | 1 | 26 | 14 | 19 | 21 | 32.0 | 11.0 | 15.0 | 14.0 | 16.0 | 168 |
| Emin Duraku' | MEDINA RRUSTEMI | 1 | 32 | 14 | 22 | 21 | 28.0 | 11.0 | 10.0 | 12.0 | 15.0 | 165 |
| A. Z. Çajupi' | SHKURTA ADEMI | 2 | 30 | 15 | 23 | 13 | 33.0 | 10.0 | 15.0 | 10.0 | 14.0 | 163 |
| SHMU-2' | KALTRINA SEFEDINI | 2 | 30 | 12 | 24 | 19 | 26.0 | 11.0 | 11.0 | 14.0 | 15.0 | 162 |

Mesataret e pikëve të nxënësve nëpër lëndë të ndryshme variojnë dhe ato janë paraqitur në tabelën në vazhdim. Natyrisht, DKA merr për bazë edhe faktin që numri i nxënësve pjesëmarrës në test dallon nga shkolla në shkollë. Ne kemi bërë edhe mesataren e peshuar të rezultateve të cilën si DKA po e përdorim për të parë më thellësisht performancën e secilës shkollë veç e veç dhe veçanërisht shkollave me numër më të madh të nxënësve.

| SHKOLLA | GJ. SHQIPE | GJ. ANGL. | HISTORI | GJEOGRAFI | MATEMATIKË | INFORMATIKË | FIZIKË | KIMI | BIOLOGJI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 qershori' | 24,31 | 8,12 | 13,12 | 12,88 | 21,19 | 8,62 | 6,12 | 6,81 | 8 |
| 28 Nëntori | 21,61 | 7,86 | 12,82 | 11,32 | 14,64 | 7,07 | 7,36 | 6,93 | 8,71 |
| 7 Marsi' | 23,13 | 12,47 | 17,13 | 9,27 | 12,33 | 9 | 6,8 | 5,87 | 9,6 |
| A. Z. Çajupi' | 20,51 | 8,43 | 12,81 | 10,15 | 13,1 | 6,2 | 5,97 | 5,33 | 6,83 |
| Abdyl Frashëri' | 22,87 | 10,07 | 13,6 | 8,87 | 13,73 | 9,2 | 7,27 | 6,2 | 6,87 |
| Adem Voca' | 20,38 | 8 | 13 | 10,08 | 15,38 | 6,92 | 6,62 | 4,77 | 7,23 |
| Azem Bejta' | 18,44 | 6,11 | 12,22 | 11,11 | 10,89 | 5,67 | 5,89 | 6,44 | 10,67 |
| Bahri Kuqi' | 21,75 | 10 | 14,96 | 12,88 | 22,5 | 9,71 | 10,08 | 9,04 | 13,21 |
| Bajram Curri' | 20,62 | 7,5 | 11,38 | 10,12 | 14,38 | 6,75 | 6,38 | 5,88 | 7 |
| Deshmoret' | 15,75 | 6,25 | 11,5 | 7,75 | 14,5 | 5,75 | 6,25 | 4,75 | 8,5 |
| Emin Duraku' | 21,94 | 7,53 | 15,12 | 13,41 | 15,47 | 7,59 | 7,29 | 7,18 | 9,65 |
| Enver Hadri' | 22,18 | 10,53 | 15,98 | 12,47 | 14,56 | 7,4 | 5,89 | 5,47 | 7,42 |
| Gj. K. Skendenderbeu' | 24,92 | 10,83 | 17,17 | 12,08 | 18,09 | 7,73 | 8,82 | 7,36 | 9,82 |
| Hajrullah Shala' | 19,67 | 8,78 | 13,06 | 9,89 | 13,28 | 6,56 | 5,39 | 5,5 | 8,22 |
| Jusuf Gërvalla' | 21,57 | 9,14 | 15 | 12,57 | 13,71 | 6,93 | 7,07 | 5,71 | 9,07 |
| Latif Berisha' | 20,64 | 8,73 | 10,95 | 9,05 | 14,05 | 10,09 | 8,95 | 5,27 | 6,95 |
| Liria' | 25,25 | 8,92 | 12,5 | 11,67 | 18,92 | 7,5 | 7,42 | 12,67 | 8,5 |
| Lumadh | 20,2 | 8,8 | 14 | 11,07 | 20,4 | 9,33 | 6,33 | 12,73 | 11,07 |
| Lumni Surdulli' | 20,65 | 7,65 | 11,85 | 9,85 | 12,3 | 5,9 | 6,85 | 5,2 | 8,2 |
| Martirët' | 21,92 | 8,15 | 12,77 | 9,54 | 10,15 | 6,77 | 7,77 | 4,92 | 9,08 |
| Migjeni' | 20,29 | 7,05 | 13,07 | 11,38 | 15,24 | 7,2 | 6,88 | 7,9 | 8,76 |
| Mustafë Shyti' | 25,5 | 12,08 | 15,67 | 9,83 | 16,58 | 9,58 | 6,33 | 7,75 | 10,58 |
| Nadakoc | 20,47 | 9,47 | 13,2 | 10,2 | 15,67 | 7,47 | 7,27 | 6,67 | 6,4 |
| Nazmi Zhegrova' | 20,33 | 7,96 | 11,67 | 10,85 | 9,37 | 5,96 | 7,15 | 5,96 | 7 |
| Pestova | 25,79 | 11,79 | 17,16 | 15,37 | 21,42 | 8,74 | 8 | 7,95 | 11,68 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Rexhep Musa' | 23,6 | 6,8 | 16,2 | 16,2 | 9,2 | 6 | 5,6 | 6 | 7,6 |
| Rilindja' | 21,67 | 9,02 | 14,36 | 12,93 | 17,5 | 9,62 | 9,26 | 10,98 | 11,48 |
| SHMU-1 | 21,97 | 9,49 | 12,3 | 11,2 | 13,72 | 7,69 | 6,34 | 6,11 | 7,68 |
| SHMU-2 | 22,81 | 10,03 | 14,27 | 12,96 | 13,86 | 7,76 | 6,84 | 6,09 | 7,53 |

Të dhënat për mesataren e pikëve të ndara sipas lëndëve dhe shkollave i ndihmojnë DKA-së të identifikoj për secilën shkollë, se ku janë nevojat për orë plotësuese, aktivitete shtesë dhe punë përgatitore për testin e radhës të arritshmërisë. Duke qenë se kemi digjitalizuar të dhënat për herë të parë, DKA ka mundësinë të shoh, veçanërisht në shkollat e mëdha, dallimet në mes të paraleleve me mësimdhënës të ndryshëm në lëndë të njejtë. Kjo do të na ndihmoj në rritjen e performancës.

DKA ka analizuar edhe matriksën e korrelacionit të lëndëve të ndryshme të cilën po e paraqesim në vazhdim.

Kjo matricë e korrelacionit paraqet korrelacionet ndërmjet lëndëve të ndryshme në të cilat nxënësit u testuan.
GJ. SHQIPE ka një korrelacion pozitiv më të theksuar me GJ. ANGL. (0.63) dhe me HISTORI (0.59). Ky rezultat tregon se nxënësit që performuan më mirë në gjuhën shqipe kanë tendencë të dalin më mirë edhe në gjuhën angleze dhe histori.
MATEMATIKA ka një korrelacion pozitiv me INFORMATIKËN (0.58) dhe KIMINË (0.52). Kjo do të thotë se studentët që performuan më mirë në matematikë kanë tendencë të dalin më mirë edhe në informatikë dhe kimi.
Korrelacionet midis disa lëndëve janë më të forta sesa të tjera, tregon se ka një ndikim më të fortë midis këtyre lëndëve.
Këto korrelacione ndihmojnë në kuptimin e marrëdhënieve ndërmjet performancës së studentëve në lëndët e ndryshme dhe në gjetjen e pattern-eve të mundshme midis tyre.




f. 19




Grafikoni paraqet shkollat dhe mesataren përkatëse të pikëve totale të marra nga nxënësit në kontekstin e dhënë. Shkolla me mesataren më të lartë të pikëve në total është "Pestova" me mesatare 127,89 pikë. Mesatarja e dytë më e lartë e pikëve totale është marrë nga "Bahri Kuqi'" me një mesatare prej 124.12 pikësh. "Rilindja" është shkolla e tretë më e shënuar me një mesatare prej 116.81 pikësh.
Shkollat me mesatare totale të pikëve nga 100 deri në 110 në përgjithësi kanë performancë të mirë, duke përfshirë "Lumadh", "Mustafë Shyti", "Liria", "Gj. K. Skendenderbeu", "12 qershori" etj.
Shpërndarja e pikëve mesatare totale na ndihmon në identifikimin e shkollave me performancë të shkëlqyer akademike dhe mund të përdoret për të bërë krahasime ose për të vlerësuar efektivitetin e sistemit arsimor.
Është e rëndësishme të theksohet se interpretimi mund të ndryshojë në bazë të kontekstit të të dhënave dhe DKA nuk ka për qëllim të paraqes rezultat negativ të shkollave. Përkundrazi, ne do të hartojmë rekomandime veç e veç për shkollat dhe do të monitorojmë zbatimin e tyre gjatë gjithë vitit shkollor, në mënyrë që rezultatet e vitit të ardhshëm, të jenë edhe më të mira.

## IV. <u>Donacionet</u>

- Drejtoria Komunale e Arsimit Vushtrri, përmes organizatës OJQ-në 'The Poëer of Mind" ka pranuar donacion nga Qeveria e Japonisë përmes fondit japonez për zhvillim social (JSDF); nga 5 llaptop dhe 1 videoproejktor për shkollat: SHFMU "Adem Voca" Pasomë, SHFMU "Emin Duraku" Novolan, SHFMU "Hajrullah Shala" Akrashticë, SHFMU " Rexhep Musa" Ceceli, gjithsej 20 llaptopë dhe 5 video projektor

- Në SHFMU "Nazmi Zhegorva" Stanoc i Poshtëm: USAID – "UP TO YOUTH" ka dhënë donacion:1 tabelë muri ( dërrasë e bardhë )1 projektor, 1 orman, 6 karrika dhe 6 banka për moshën 5- 6 vjeq30, pako libra për fëmijë te klasës parafillore;
- Dhurata për nxënës të shkollës SHFMU "Hajruallah Shala" Akrashticë: "Union" Vushtrri", 192.50 € Vipa Chips" Pestovë 69.62 "Molitoria" Bukosh 93.60 €, "Edona Market" Vushtrri92.50 € , "Rami Pack" Lipjan 84.50 €;
- SHFMU "Rexhep Musa"Ceceli pranoi donacion: Pompe uji ( raketë) nga kompania "Zariqi", pronar Qaush Zariqi,3. lavaman uji nga çimentoja, për çezmën e ujit, vendosur në oborr të shkollës, nga Kompania "Butrinti" ;
- SHFMU "Bahri Kuqi" Shtruerë: ka pranuar donacion nga kompania "AMIS COMPANI" e shpërblen me 180 Euro ose me 12 palë fanela.

## V. Bashkëpunimet me organizata

- Caritasi zviceran; bashkëpunimi për zbatimin e projektit ndikimi i rinisë në mjedis i cili në fazën e zbatimit i cili projekt ka vlerën 8800.00 euro dy shkollat e mesme ; ShMP "Bahri Haxha" Vushtrri, Gjimnazi " Eqrem Çabej" Vushtrri;
- Center for Education and Development of Environment – CEDE: trajnimet për eko-klubet në dy shkolla të mesme
- OJQ-në 'The Power of Mind" : digjitalizimi i shkollave;
- KEC ( Qendra për Arsimin në Kosovë): projekti "KIST+"_DOKUFEST/KEC; Së bashku kundër abuzimit të fëmijëve,
- Shoqata profesionale e informaticientëve të Kosovës; kodimi;
- Organizata TOKA: për talentet në arsim;
- Organizata GIZ: për orientim në karrierë;
- Organizata ECMI: për EPRBM ( për reagim dhe parandalim të braktisjes);
- Organizata Lux- dev: për shkolla profesionale;
- Qendra Psiko-Sociale për Traumaterapi- Mitrovicë: këshillim për mësimdhënës'
- OJQ "BIODIVERSITETI" Vushtrri: për ambient;
- "Fondacioni Jahjaga": dhuna në familje dhe orientimi në karrierë;
- UP TO YOUTH- USAID: aktivitet për të rinjtë e shkollave;
- Organizata VORAE: arsimimi i komuniteteve;
- Organizata "Gjurmët": çështje kulturore artistike;
- Green Art Center Prishtina: ambienti në shkolla;

## VI. Garat sportive

- Në garat komunale të volejbollit kategoria M, SHFMU "Bahri Kuqi" Shtitaricë ka zënë vendin e parë;
- Në garat Regjionale në volejboll, kategoria M. Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri ka zënë vendin e parë;
- Në garat komunale dhe regjionale në Volejboll kategoria F , SHFMU- Pestova i P. ka zënë vendin e parë;
- Në garat komunale në volejboll kategoria M, SHFMU- Pestova i P. ka zënë vendin e dytë;
- Në garat komunale në volejboll kategoria M/F , SHFMU "Nazmi Zhegrova'' Stanoc i P. ka zënë vendin e tretë;
- Në gara komunale në volejboll kategoria F, SHMU-1, ka zënë vendin e dytë;
- Në garat komunale në hendboll kategoria M, Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri ka zënë vendin e parë;
- Në garat komunale dhe regjionale në hendboll kategoria M/F, SHFMU "A.Z.Çajupi'' Vushtrri ka zënë vendin e parë
- Në gara komunale në hendboll kategoria M, SHMU-1, ka zënë vendin e dytë;
- Në gara komunale në hendboll kategoria F, SHMU-1, ka zënë vendin e tretë;

- Në garat komunale në ping- pong kategoria M, Gjimnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri ka zënë vendin e parë;
- Në garat komunale dhe regjionale në ping- pong kategoria M, SHMU-2 Vushtrri ka zënë vendin e parë;
- Në garat Republikane në ping- pong, kategoria M. Gjimnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri ka zënë vendin e dytë;
- Në garat komunale dhe regjionale në ping- pong kategoria F, SHFMU “Liria'' Stroc, ka zënë vendin e parë
- Në garat komunale në basketboll kategoria M, dhe F. Gjimnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri ka zënë vendin e parë;
- Në garat Regjionale në basketboll, kategoria F. Gjimnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri ka zënë vendin e parë;
- Në garat komunale në basketboll kategoria F, SHMU-2 Vushtrri ka zënë vendin e parë dhe vendi i dytë M.
- Në garat regjionale në basketboll kategoria F, SHMU-2 Vushtrri ka zënë vendin e parë.
- Në garat komunale basketboll kategoria M, SHFMU “Hajrullah Shala'' Akrashticë, ka zënë vendin e tretë;
- Në gara komunale në basketboll kategoria F, SHMU-1, ka zënë vendin e dytë;
- Në garat komunale në futsall, kategoria M,dhe F. Gjimnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri ka zënë vendin e parë;
- Në garat Regjionale në futsall, kategoria M. Gjimnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri ka zënë vendin e parë;
- Në garat Republikane në futsall, kategoria F. Gjimnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri ka zënë vendin e parë;
- Në garat komunale futsall kategoria M, SHFMU “A.Z.Çajupi'' Vushtrri ka zënë vendin e parë
- Në garat regjionale futsall kategoria M, SHFMU “A.Z.Çajupi'' Vushtrri ka zënë vendin e dytë;
- Në garat Komunale, Regjionale, Republikane në fustall, kategoria SHFMU “Liria” Stroc ka zënë vendin e parë;
- Në Garat Komunale “Vajzat duan të luajnë futboll” grupmosha 9-13 SHFMU “Liria” Stroc ka zënë vendin e parë;
- Në gara komunale në futboll kategoria M, SHFMU “Nazmi Zhegrova'' Stanoc i P. ka zënë vendin e dytë;
- Në gara komunale në Futboll kategoria M, SHMU-1, ka zënë vendin e dytë;

VII. <u>Aktivitetet për sigurinë në shkollat e Vushtrrisë</u>

- Gjysëmvjetori i dytë i vitit shkollor 2022/23 mund të quhet lirisht gjysëmvjetori i sigurisë në shkolla. I kemi dhënë prioritet të lartë sigurisë në shkolla. DKA ka bashkëpunuar me Policinë e Kosovës, shkollat, komunitetin, akterët e shoqërisë civile dhe grupet e specializuara për të rritur sigurinë në shkolla.

- Qendra Psiko-Sociale për Traumaterapi, ka organizuar tryezë me temë: “Trauma dhe ofrimi i ndihmës/trajtimit” në hapësirat e Kalasë së qytetit të Vushtrrisë me datën 16 shtator 2022 (e premte) nga ora 10:00-13:0 dhe ligjërata në 5 shkolla: SHF "Naim Frashëri" , SHFMU "Enver Hadri", SHFMU" A.Z.Çajupi" , SHFMU “Lumni Surdulli”, SHFMU "Migjeni" SHMU-2Vushtrri;
- Më 18 nëntor 2022; u mbajt EKSPOZITË “Së bashku kundër abuzimit të fëmijëve” organizuar nga KEC, TACA dhe DKA;
- Më 18 nëntor 2022 ; Tryezë diskutimi në SHMU-1 me temë; 19 Nëntorin – "Ditën Botërore të Parandalimit të Abuzimit të Fëmijëve“.
- Më datë 10.11 dhjetor 2022 u mbajt trajnimi me 10 shkolla, me temë: 'Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve'': SHFMU “Rilindja ” Maxhunaj, SHFMU – Pestova SHMU-1 , SHMU-

2, SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri, SHFMU "Bahri Kuqi" Shtruerë, SHFMU "Hajrullah Shala" Akrashticë ,SHFMU " Emin Duraku" Novolan, SHFMU "Adem Voca" Pasomë, SHFMU "Latif Berisha" Dobërllukë ;

- o
  -Janë trajnuar ekipet për 10 shkolla për Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve";
  -Janë themeluar ekipet "Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve", për dhjetë shkollat e Komunës së Vushtrrisë;
  -Janë trajnuar 222 mësimdhënës;
  -Janë trajnuar 2401 nxënës;
  -Ekipet shkollore u synuam: 10 janë themeluar 10 , 100%;
  -Trajnimi i synuar për nxënës : 2684nx. ndërsa u trajnuam 2401nx. pra u realizua 89%;
  -Trajnimi i synuar për mësimdhënës 330 mësimdhënës, ndërsa u trajnuan 222 mësimdhënës pra u realizua 67%;

- Njësiti Komunal për të Drejtat e Njeriut, për ta shënuar 10 Dhjetorin – Ditën Botërore të Drejtave të Njeriut, ka organizuar garën për tri esetë më të mira;
- Në SHMU-1 u mbajt ligjëratë Me temën "Siguria në internet", nga drejtoresha e Innovation Academy, Fatbardha Dallku, dhe në të gjitha shkollat e komunës u shënua dita e internetit të sigurt.
- Ligjëratat nga policia, tema për muajin dhjetor 2022, sulmet me laser në drejtim të aeroplanëve nga data:06.12.2022- 09.12.2022; ( të përfshira 10 shkolla).
- Ligjërata nga policia, tema për muajin shkurt 2023 :Respektimi i shumëllojshmerisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit te dhunshëm VIII-IX. ( të përfshira 10 shkolla).
- Ligjërata nga policia Tema "Lojërat e Rrezikshme" muaji mars, (të përfshira 30 shkolla).
- Ligjëratë nga policia, tema për muajin mars 2023: Parandalimi i ngacmimeve seksuale dhe masat ligjore ndëshkimore ( të përfshira 10 shkolla).
- Ligjërata nga policia,tema për muajin prill 2023: Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit ( të përfshira 10 shkolla).
- Ligjërata nga policia, tema për muajin maj 2023: Dhuna në familje ( të përfshira 10 shkolla)
- Më 30 mars 2023 në Vushtrri, në partneritet me ECMI u takuam me EPRBM komunale dhe të shkollave të mesme të larta, për të rritur përkushtimin institucional në parandalim të braktisjes dhe motivim të zhvillimit të fëmijëve brenda potencialit të plotë. Si dhe më 22 qershor me shkolla të mesme të ulëta
- Njësiti anti-drogë nga Mitrovica, ka mbajt ligjëratë; Për efektet negative dhe rreziku nga abuzimi me narkotik, në 5 shkolla të komunës së Vushtrrisë.
- Më 26 maj 2023, Policia e Kosovës - Departamenti i Policisë në Bashkësi, në kuadër të projektit "Parandalimi i Dukurive të Zjarreve" i cili ka pasur për qëllim, të eliminohen - zvogëlohen burimet e shkaktimit të zjarreve, kanë mbajt ligjëratë me nxënës të klasave të 8-ta dhe të 9-ta, lidhur me parandalimin e zjarreve.
- Më 26 Qershori, Dita botërore kundër drogës, një ditë e rëndësishme e cila shënohet çdo vit për të ngritur vetëdijen dhe për të luftuar çështjen e abuzimit me substanca në tërë botën. Në këtë ditë, njësitë e Stacionit Policor Vushtrri, gjegjësisht zyrtarët policor të SP- Vushtrri përmes aktiviteteve policore mbajtën fushatë vetëdijësuese mbi këtë temë si dhe shpërndanë fletushkat "Stop drogës". Shkolla SHMU-2 organizoi gjithashtu aktivitet mbi shkakun dhe pasojat që mund të sjellë përdorimi i drogave në moshën e hershme. Aktiviteti u organizua nga psikologia e shkollës;
- Gratë dinë: T'i japim fund dhunës me bazë gjinore". –Fondacioni Jahjaga; Përmes gjashtë takimeve javore të grave të cilat janë organizuar, projekti ka ofruar një qasje se si nënat mund të parandalojnë ose shmangin dhunën për veten dhe njerëzit përreth tyre. Takimet ndjekin një koncept holistik që eksploron mekanizmat individual dhe shoqërorë të dhunës dhe

përvojën e dhunës, me fokus parandalimin. Secili takim udhëhiqet nga dy lidere të trajnuara. Takimet janë mbajtur në muajin Maj 2023;

- Instituti Pedagogjik, më 28 prill 2023 në SHMU-2 Zyrtarë nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, MASHT dhe DKA, realizuan një punëtori me nxënës me përmbajtje lidhur me parandalimin dhe identifikimin e rasteve të dhunës në familje ndaj fëmijëve;
- Në kuadër të programit "Edukimi për Siguri" nga FSK, kanë qëndruar për dy ditë në kazermën e FSK-së në Mitrovicë 30 nxënës të shkollave të mesme të Vushtrrisë;

## VIII. Suksesi i gjysmëvjetorit të dytë 2022/23

Deri në hartimin e kësaj informate, shkollat ende nuk kanë përmbyllur procesin e raportimit të të dhënave në sistemin SMIA. Sistemi do të jetë i hapur deri me datë 16 korrik 2023 dhe DKA është në komunikim të vazhdueshëm me shkollat që informatat të jenë të sakta dhe raportimi të jetë në kohë. DKA do të bëjë plotësimin e kësaj informate sapo të kemi të dhënat e shkollave rreth suksesit në gjysëmvjetorin e dytë.

**Suksesi gj.II-2022 /2023**

| Klasë | Shkëlqyeshëm | % | Sh. mirë | % | Mirë | % | Mjaftueshëm | % | Të pa notuar | % | Me një notë të dobët | % | Me dy nota të dobëta | % | Kanë përsëritur klasën | % | Me tri e më shumë nota të dobëta | % | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa 1 | 816 | 81.85 | 111 | 11.13 | 51 | 5.12 | 17 | 1.71 | 2 | 0.20 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 997 |
| Klasa 2 | 674 | 69.70 | 166 | 17.17 | 90 | 9.31 | 36 | 3.72 | 1 | 0.10 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 967 |
| Klasa 3 | 595 | 62.70 | 220 | 23.18 | 105 | 11.06 | 24 | 2.53 | 1 | 0.11 | 4 | 0.42 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 949 |
| Klasa 4 | 617 | 60.43 | 246 | 24.09 | 117 | 11.46 | 40 | 3.92 | 1 | 0.10 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1021 |
| Klasa 5 | 611 | 57.75 | 252 | 23.82 | 162 | 15.31 | 32 | 3.02 | 1 | 0.09 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1058 |
| Gj. | 3313 | 66.37 | 995 | 19.93 | 525 | 10.52 | 149 | 2.98 | 6 | 0.12 | 4 | 0.08 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4992 |

f. 25

| Klasë | Shkëlqyeshëm | % | Sh. mirë | % | Mirë | % | Mjaftueshëm | % | Të pa notuar | % | Me një notë të dobët | % | Me dy nota të dobëta | % | Kanë përsëritur klasën | % | Me tri e më shumë nota të dobëta | % | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa 6 | 315 | 32.47 | 227 | 23.40 | 263 | 27.11 | 113 | 11.65 | 4 | 0.41 | 34 | 3.51 | 14 | 1.44 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 970 |
| Klasa 7 | 289 | 28.22 | 223 | 21.78 | 295 | 28.81 | 112 | 10.94 | 5 | 0.49 | 68 | 6.64 | 29 | 2.83 | 3 | 0.29296875 | 0 | 0 | 1024 |
| Klasa 8 | 259 | 26.84 | 190 | 19.69 | 236 | 24.46 | 157 | 16.27 | 7 | 0.73 | 79 | 8.19 | 31 | 3.21 | 6 | 0.621761658 | 0 | 0 | 965 |
| Klasa 9 | 343 | 33.89 | 214 | 21.15 | 275 | 27.17 | 156 | 15.42 | 3 | 0.30 | 16 | 1.58 | 5 | 0.49 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1012 |
| Gj. | 1206 | 30.37 | 854 | 21.51 | 1069 | 26.92 | 538 | 13.55 | 19 | 0.48 | 197 | 4.96 | 79 | 1.99 | 9 | 0.226643163 | 0 | 0 | 3971 |

| Klasë | Shkëlqyeshëm | % | Sh. mirë | % | Mirë | % | Mjaftueshëm | % | Të pa notuar | % | Me një notë të dobët | % | Me dy nota të dobëta | % | Kanë përsëritur klasën | % | Me tri e më shumë nota të dobëta | % | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa 10 | 90 | 11.00 | 144 | 17.60 | 214 | 26.16 | 260 | 31.78 | 6 | 0.73 | 42 | 5.13 | 19 | 2.32 | 11 | 1.34 | 32 | 3.91 | 818 |
| Klasa 11 | 155 | 19.04 | 147 | 18.06 | 237 | 29.12 | 172 | 21.13 | 0 | 0.00 | 68 | 8.35 | 23 | 2.83 | 0 | 0.00 | 12 | 1.47 | 814 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa 12 | 149 | 20.14 | 162 | 21.89 | 243 | 32.84 | 166 | 22.43 | 1 | 0.14 | 14 | 1.89 | 5 | 0.68 | 0 | 0.00 | 0 | 0.00 | 740 |
| Gj. | 394 | 16.61 | 453 | 19.10 | 694 | 29.26 | 598 | 25.21 | 7 | 0.30 | 124 | 5.23 | 47 | 1.98 | 11 | 0.46 | 44 | 1.85 | 2372 |

Suksesi i nxënësve sipas niveleve dhe krahasimi me vitin paraprak

| Suksesi i Gjysmëvjetorit të dytë në krahasim me gjysëmvjetorin e dytë të vitit paraprak - Niveli 1 -5 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Periudha e njejtë | Shkëlqyeshëm | % | Sh. mirë | % | Mirë | % | Mjaftueshëm | % | Të pa notuar | % | Me një notë të dobët | % | Me dy nota të dobëta | % | Kanë përsëritur klasën | % | Me tri e më shumë nota të dobëta | % | Gjithsej |
| 2022/23 | 331<br>3 | 66.37 | 995 | 19.93 | 52<br>5 | 10.52 | 14<br>9 | 2.98 | 6 | 0.12 | 4 | 0.08 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 499<br>2 |
| 2021/22 | 330<br>9 | 65.43 | 105<br>1 | 20.78 | 52<br>7 | 10.42 | 16<br>2 | 3.20 | 2 | 0.04 | 6 | 0.12 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 505<br>7 |
| Krahasim<br>i | 4 | 0.93213<br>4 | -56 | -<br>0.85118 | -2 | 0.09562<br>9 | -<br>13 | -<br>0.2187 | 4 | 0.08064<br>3 | -2 | -<br>0.03852 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | -65 |




| Suksesi 1-5 | | |
|---|---|---|
| Periudha e njejtë | Pozitiv | Negativ |
| 2022/23 | 4888 | 4 |
| 2021/22 | 5051 | 6 |




f. 28

| Suksesi i Gjysmëvjetorit të dytë në krahasim me gjysëmvjetorin e dytë të vitit paraprak - N iveli 6-9 | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Periudha e njejtë | Shkëlqyeshëm | % | Sh. mirë | % | Mirë | % | Mjaftueshëm | % | Të pa notuar | % | Me një notë të dobët | % | Me dy nota të dobëta | % | Kanë përsëritur klasën | % | Me tri e më shumë nota të dobëta | % | Gjithsej |
| 2022/23 | 1206 | 30.37 | 854 | 21.51 | 1069 | 26.92 | 538 | 13.55 | 19 | 0.48 | 197 | 4.96 | 79 | 1.99 | 9 | 0.226643 | 0 | 0 | 3971 |
| 2021/22 | 1179 | 29.13 | 872 | 21.54 | 1073 | 26.51 | 700 | 17.29 | 4 | 0.10 | 112 | 2.77 | 87 | 2.149209 | 21 | 0.518775 | 0 | 0 | 4048 |
| Krahasimi | 27 | 1.24469 | -18 | -0.03558 | -4 | 0.413254 | -162 | -3.74427 | 15 | 0.379655 | 85 | 2.194169 | -8 | -0.15979 | -12 | -0.29213 | 0 | 0 | -77 |




| Suksesi 6-9 | | |
|---|---|---|
| Periudha e njejtë | Pozitiv | Negativ |
| 2022/23 | 3686 | 285 |
| 2021/22 | 3828 | 220 |



| Suksesi i Gjysmëvjetorit të dytë në krahasim me gjysëmvjetorin e dytë të vitit paraprak - Niveli 10-12 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Periudha e njejtë | Shkëlqyeshëm | % | Sh. mirë | % | Mirë | % | Mjaftueshëm | % | Të pa notuar | % | Me një notë të dobët | % | Me dy nota të dobëta | % | Kanë përsëritur klasën | % | Me tri e më shumë nota të dobëta | % | Gjithsej |
| 2022/23 | 394 | 16.61 | 453 | 19.10 | 694 | 29.26 | 598 | 25.21 | 7 | 0.30 | 124 | 5.23 | 47 | 1.98 | 11 | 0.463744 | 44 | 1.854975 | 2372 |
| 2021/22 | 341 | 13.78 | 492 | 19.88 | 744 | 30.06 | 502 | 20.28 | 11 | 0.44 | 145 | 5.86 | 180 | 7.272727 | 4 | 0.161616 | 50 | 2.020202 | 2475 |




| Suksesi 6-9 | | |
|---|---|---|
| Periudha e njejtë | Pozitiv | Negativ |
| 2022/23 | 2146 | 226 |
| 2021/22 | 2096 | 379 |



## Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Gjatë periudhës gjashtë mujore nga DSHPS janë realizuar te gjitha kërkesat nga Shërbimet e Kujdesit Primar, QPS dhe Shërbimet Rezidenciale për mallra e shërbime, komunali etj.

Investimet Kapitale te cilat janë të zotuara e të cilat janë në procedura te prokurimit:

- Pajisje Mjekësore ---50,000.00€
- Ndërtimi i zyrave të administratës në QKMF---31,000.00€
- Blerja e inventarit për QKMF-në---50,000.00€
- Izolimi i brendshëm dhe rregullimi i dyshemesë---33,360.00€
- Sistemi i ujitjes nën tokë në oborret e QKMF-së, QMF-së---30,000.00€
- Rregullimi i oborrit në QKMF –Vushtrri-----11,000.00€
- Blerja e automjetit të terrenit në QKMF Vushtrri----39,000.00€
- Blerja dhe montimi i klimave në QKMF-----20,000.00€
- Blerja e autoambulancës me pajisje përcjellëse---86,000.00€
- Blerja e kamerave për objektin e QKMF, QMF----20,000.00€
- Rregullimi i hapësirave për gjenerator---10,000.00€
- Izolimi i kulmit në QMF 1 dhe ngjyrosja e objektit----95,000.00€
- Ndërtimi i objektit për laborator në Lum Madh--------3,042.00€
- SHERBIMET REZIDENCIALE
- Blerja e veturës për shërbimet rezidenciale—15,000.00
- QENDRA PËR PUNË SOCIALE
- Blerja e gjeneratorit për QPS------------------------ 2,800.00€
- Rregullimi i nyjave sanitare QPS--------------------3,042.00€
- Nga fondi i subvencioneve kemi ndihmuar një numër të konsiderueshëm të rasteve me sëmundje të rënda shëndetësore dhe rasteve sociale, 177 përfitues ne shume prej 39,800.00€;
- Kemi subvencionuar 82 përfitues për shtesat për fëmije ne shume prej 9,960.00€;
- Kemi fuqizuar dhe rritur kapacitetet e shërbimit të terrenit për rastet e sëmundjeve kronike, lehonat si dhe fëmijët deri ne moshën 3 vjeç nga marrëveshja që kemi me Islamic Relief.

## QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

**Raporti i shërbimeve shëndetësore për peridhën janar – qershor 2023**

| Nr. | Emri i sherbimit | Totali | Meshkuj | Femra | Participim | Sherbim | Referime | Malinje | Kronike | Te vizituar me kartele |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | QKMF | 31361 | 14960 | 16401 | 4786 | 98446 | 1925 | 18 | 1682 | 562 |
| 2 | Urgjenca | 17319 | 7815 | 9504 | 1893 | 85386 | 2321 | 126 | 2196 | 0 |
| 3 | Laboratori | 7692 | 3054 | 4639 | 2334 | 88880 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Stomatologjia | 4210 | 1929 | 2281 | 440 | 18904 | 107 | 0 | 0 | 397 |
| 5 | RTG | 2733 | 1185 | 1548 | | 8043 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Rtg e dhembit | 225 | 88 | 137 | 27 | 515 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 7 | Vaksinimi | 2170 | 1149 | 1021 | 0 | 8302 | 0 | 0 | 0 | 1092 |
| 8 | QMF-1 | 32493 | 15215 | 17278 | 5770 | 90852 | 3878 | 6 | 2041 | 993 |
| 9 | QMF-2 | 2717 | 1250 | 1467 | 435 | 17046 | 145 | 4 | 188 | 325 |
| 10 | QMF-3 | 3706 | 1797 | 1909 | 674 | 28081 | 16 | 0 | 719 | 1281 |
| 11 | QMF-AMF | 10655 | 4511 | 6144 | 1375 | 51029 | 2847 | | 1283 | 1526 |
| 12 | V.SHTEPIAKE | 2202 | 928 | 1274 | 0 | 10720 | 5 | 0 | 0 | 0 |
| 13 | KshillimoreAQH | 588 | 290 | 298 | 0 | 2350 | 0 | 0 | 673 | 20 |
| | Gjithsejt: | 118 071 | 54 171 | 63 901 | 18 231 | 508 554 | 11 244 | 175 | 8 782 | 6 196 |

**Do të paraqesim në formë tabelare rrjetet e QMF dhe AMF** ***Janare Qershor 2023***

| | | Totali | M | F | Referimet | Participim | Shërbime tjera | Vizita me kartele | S.Malinje | S.Kronike |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| QMF dhe AMF | *QMF Lumadh* | *3326* | *1368* | *1958* | *128* | *510* | *17998* | *397* | *6* | *303* |
| | *QMF Smrekonice* | *1134* | *496* | *638* | *538* | *180* | *4869* | *67* | *1* | *117* |
| | *QMF Pantine* | *1257* | *514* | *743* | *417* | *255* | *5431* | *446* | *13* | *204* |
| | *QMF Druar* | *546* | *251* | *295* | *233* | *43* | *1874* | *4* | *0* | *15* |
| | *QMF Novolane* | *348* | *156* | *192* | *129* | *13* | *1993* | *205* | *0* | *52* |
| | *QMF Maxhunaj* | *1864* | *725* | *1139* | *870* | *309* | *6098* | *0* | *1* | *224* |
| | *QMF Dumnice* | *313* | *158* | *155* | *136* | *11* | *1490* | *189* | *0* | *28* |
| | *AMF Samadrexhe* | *491* | *193* | *298* | *145* | *31* | *3134* | *218* | *0* | *183* |
| | *AMF Strovc* | *421* | *180* | *241* | *151* | *12* | *1272* | *0* | *0* | *99* |
| | *AMF Pasome* | *292* | *134* | *158* | *4* | *0* | *1288* | *5* | *0* | *14* |
| | *AMF Oshlan* | *147* | *71* | *76* | *41* | *3* | *480* | *0* | *0* | *11* |
| | *AMF Beciq* | *246* | *121* | *125* | *32* | *0* | *821* | *0* | *0* | *0* |
| | *Amf Dubovc* | *106* | *75* | *31* | *12* | *0* | *340* | *0* | *0* | *0* |
| | *AMF Ceceli* | *164* | *69* | *95* | *10* | *8* | *1371* | *0* | *0* | *33* |
| | **Gjithsej:** | ***10655*** | ***4511*** | ***6144*** | ***2846*** | ***1375*** | ***48459*** | ***1531*** | ***21*** | ***1283*** |

**Sektori i Shëndetit Publik -** Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike:

| Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| SHFMU | Nxënës të planifikuar | | Munguar | | Vizita të realizuara | |
| | Nr. nxënësve | % | Nr. nxënësve | % | Nr. nxënësve | % |
| **Klasa I** | 1208 | 100 | | | | |
| **Klasa V** | 1074 | 100 | | | | |
| **Klasa IX** | 1021 | 100 | | | | |
| Gjithësej | 3303 | 100 | | | | |

Të gjeturat sipas kritereve të caktuara përqindje në përqindje do te figurojnë në raportin 12 mujor 2023 dhe në raportin e veçantë i cili do ti prezantohet Drejtorisë me rastin e përfundimit.

Njësia e SISH-it, QKMF në Vushtrri është duke funksionuar me sistemin e ri i cili është me versionin e fundit. Ministria e Shëndetësisë ka bërë shtrirjen e rrjetit për të gjitha QMF dhe AMF, po ashtu ka pajisur KPSH me pajisje komjuterike dhe pajsije tjera të TI, është duke u punuar në vazhdimësi për implementimin e të gjitha qendrave dhe shpresojmi që gjatë vitit 2023 të funksionalizohet SISH-I në të gjitha instuticionet e KPSH-së.

## Sektori i Shëndetit Oral Preventiv

Në formë tabelare paraqiten shërbimet e ofruara në sektorin e Shëndetit Oral

| Pacienta | Bllomba | Dhëmbë të nxjerrë | Shërbime | Intervenime të tjera | Me mjekim | Participime |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4031 | 359 | 1168 | 18056 | 1431 | 1108 | 426 |

## Shërbimi i Urgjencës

- Gjatë Janar – Qershor 2023. Në Urgjencë shërbimet janë 24$^h$ dhe punohet cdo ditë të javës. Në këtë shërbim janë të angazhuar katër ekipe që punojnë me ndërrime 12 orësh, janë të angazhuar 5 mjek dhe 17 infermier, këtu kryhen vizita mjekësore dhe shumë shërbime tjera që dalin nga këto vizita. Urgjenca transporton pacientet nga vendi i ngjarjes deri në Emergjencën e Spitalit Sheikh Zayed në Vushtrri e nëse kërkohet ndihmë nga Emergjenca e spitalit, transportoen pacientët sipas nevojë në SHSKUK Prishtinë. Në disa raste ofrojn vizita dhe shërbime shëndetësore edhe në shtëpi, kur gjendja e pacientit është e rënd.

Rastet e konfirmuara të vdekjes sipas tabelës gjithësej, meshkuj, femra dhe mosha mesatare e vdekjeve:

Sektori i kujdesit urgjent lidhur me vdekjet janar - qershor 2023

| Muaji | Gjithsejtë | Meshkujt | Mosha mesatare e meshkujve | Femra | Mosha mesatare e femrave | Mosha mesatare e vdekjeve ne total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 18 | 10 | 71.3 | 8 | 71.25 | 71.2 |
| Shkurt | 10 | 3 | 74.66 | 7 | 76.57 | 75.6 |
| Mars | 14 | 6 | 65 | 8 | 76.33 | 70.06 |
| Prill | 22 | 12 | 70.03 | 10 | 74.02 | 72.2 |
| Maj | 15 | 7 | 69.05 | 8 | 73.4 | 71.4 |
| Qershor | 20 | 9 | 70.01 | 11 | 74.1 | 72 |
| **Totali** | **99** | **47** | | **52** | | |

Barnatorja Qendrore

Ka për detyrë të bëjë planifikimin, organizimin, ruajtjen e zingjirit të ftohtë dhe liferimin e produkteve medicinale nëpër QMF dhe AMF. Për shkak te mungesave gjatë furnizimit me barna dhe material shpenzues nga Ministria e Shëndetësisë, QKMF ka qenë e detyruar të bëjë blerjet e tyre nga buxheti i komunës të ndarë për blerjet e produkteve medicinale dhe material shpenzues, përmes kornizë kontratës me furnizuesin "MEDPLUS ShPK":

| Nr. | Vlera e blerjesë € |
|---|---|
| 1 | 12,487.80 |
| 1 | 11,010.80 |
| **Gjithsej** | **23,498.60** |

Në tabelën e mëposhtme janë të bashkangjitur furnizimet nga M.Sh. me barna dhe material shpenzues për periudhën kohore janar – maj 2023, nga lista esenciale:

| Nr. | Muaji | Barnat | Material shpenzues |
|---|---|---|---|
| 1 | Janar | 31.65% | 75% |
| 2 | Shkurt | 13.92% | 80% |
| 3 | Mars | 30.38% | 75% |
| 4 | Prill | 26.58% | 70% |
| 5 | Maj | 27.84% | 72.22 |
| 6 | Qershor | 31.64% | 70.00% |
| | **Mesatarja** | **27.00%** | **73.70%** |

Depoja Qendrore Farmaceutike gjatë periudhës 6 mujore të këtij viti ka bërë shpërndarjen e barnave dhe materialit shpenzues në gjithsej 18 QMF dhe AMF të komunës së Vushtrrisë, ne interval te caktuara kohore, QMF dhe AMF për çdo muaj, ndërsa QKMF dhe QMF-1 në intervale 2 javore.

Raporti i bombolave të oksigjenit medicinal Janar – qershor 2023

| Nr. | Përshkrimi | Dhënia | Sasia | Totali |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bombola oksigjeni medicinal 8.5 kg | Pacient | 123 | 123 |
| 2 | Bombola oksigjeni medicinal 8.5 kg | Insitucionet/QKMF/QMF/AMF | 29 | 29 |
| 3 | Dhënia e aparatit koncentrator | Pacientë | 3 | 3 |
| Totali | | | 155 | 155 |

Shërbimi vizitat shtëpiake për gra shtatzëna, lehona dhe fëmijët deri ne moshën 3 vjeçe. Në koordinim dhe bashkëpunim të MSH, UNICEF-in dhe AMC-ën vazhdohet të implementimet programi i vizitave shtëpiake për gra shtatzëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare

| Komuna VUSHTRRI | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i vizitave për fëmijët 0-3 vjeç | 383 | 314 | 338 | 223 | 295 | 339 | **1892** |
| Numri i vizitave për shtatzëna | 59 | 47 | 45 | 23 | 78 | 58 | **310** |
| Numri total i vizitave. | **442** | **361** | **383** | **246** | **373** | **397** | **2202** |

Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Ëorldëide-Zyra në Kosovë dhe Komuna Vushtrri , në kuadër të realizimit të projektit paraqitet raporti gjashtë mujor:

**Projekti është realizuar sipas Objektivave të shtojcës B të marrëveshjes për ofrimin dhe dhënien e shërbimeve mjekësore si :**

- Gratë shtatzëna dhe lehonat;
- Mosha e tretë mbi moshën 65 vjeçare;
- Personat me aftësi të ndryshme;
- Personat me sëmundje kronike;
- Personat me sëmundje malinje;

Për ofrimin e shërbimeve mjekësore janë furnizuar sipas kërkesës:

1. Furnizimi me barëra dhe material shpenzues mjekësore;
2. Furnizimi me Uniforma dhe çanta për mbajtjen e terapisë për staf;
3. Furnizimi me karburant për vetura, servisimi dhe mirëmbajtja e veturave;

Organizimi i punës:

Qytetarët e komunës së Vushtrrisë në nevojë ofrimin e shërbimeve mjekësore përveç vizitave mjekësore, janë dhënë shërbime të ndryshme si dhe janë aplikuar terapitë e nevojshme nga projekti sipas listës esenciale të Ministrisë së Shëndetësisë.

Nga muaji janar 2023 projekti konkretisht realizohet me përpikëri sipas marrëveshjes ku kemi 6 ekipe mjekësore të përbërë nga 1 mjek dhe 2 infermier. Puna për ofrimin e shërbimeve mjekësore ditore është kryer sipas këtij plani dy ekipe mjekësore ( 2 mjek dhe 4 infermier), njëri ekip i cili e organizon punën për dhënien e shërbimeve mjekësore në vise urbane, kurse tjetri në vise rurale, me dy automjete, terapinë dhe materialin e nevojshëm për ofrimin e shërbimeve mjekësore, si këshillimin (pacientët me sëmundje kronike, pacientët me sëmundje malinje, shtatzënat dhe lehonat etj.), vizitat mjekësore, marrjen e anamnezës, matjen e tensionit, matjen e glukozës, matjen e saturimit, matjen e pulsit, matjen e temperaturës, përshkrimin e terapisë sipas

nevojës, EKG, dhënien e terapisë paranterale ( intravenoze dhe intramuskulare), kateterizimin, pastrim dhe fashim të plagës deri në shërim, referime tek nivelet tjera të kujdesit shëndetësor sipas nevojës.

Orari i punës është 7/13 orë, që do të thotë se punohet 7 ditë të javës me orar 13 orë duke përfshirë edhe vikendet, festat etj.

Për realizimin e projektit momentalisht janë të angazhuar këto resurse humane:

| Pozita profesionale | Numri i nëpunësve |
|---|---|
| Doktor të Mjekësisë | 7 |
| Infermier të Përgjithshëm | 14 |
| Teknik laborant | 2 |
| Asistent stomatologu | 1 |

**Qendra për Punë Sociale**

Në periudhën raportuese kanë ardhë në shprehje maksimale të gjitha grup moshat të shprehura përmes kategorive të ndryshme të mbrojtjes sociale dhe janë ofruar shërbime apo forma adekuate të mbrojtjes sociale. Krahasuar me vitin paraprak kemi ngritje të shërbimeve dhe të kategorive të ndryshme të mbrojtjes sociale.

Asistenca sociale

Pranë QPS-së, Vushtrri në Asistencë Sociale janë 1259 familje, prej tyre 1208 familje me 5337 anëtarë janë shqiptarë si dhe 52 familje me 121 anëtarë janë minoritete. Gjatë këtij viti janë parashtruar 34 kërkesa për asistencë sociale, prej të cilave 22 janë aprovuar kurse, 12 prej tyre janë refuzuar. Ndërsa janë riaktivizuar 14 familje. Asistenca sociale i është ndërprerë 88 familjeve, të cilat kanë qenë shfrytëzuese të asistencës sociale.

Gjatë kësaj periudhe në komision mjekësor janë dorëzuar dhe trajtuar 681 aplikantë. Prej tyre janë aprovuar nga KM 649 aplikues, janë refuzuar 32 aplikues, ndërsa në rishqyrtim kanë qenë 52.

Janë shpërndarë ndihma në pako për shfrytëzuesit e ndihmës sociale përkrahur nga organizata të ndryshme Organizata Relief Islamic ka shpërndarë 200 pako ushqimore si dhe 200 me mish dhe Ambasada e Shteteve Arabe 100 pako ushqimore.

Shërbimet Sociale

krahasuar me vitin paraprak numri i klientëve ka pasur ngritje si rezultat i trajtimit të kategorive të reja. kemi pasur 17 raste të trajtimit të bashkëshortëve me marrëdhënie të çrregulluara ose në procedurën e shkurorëzimit, ku prej tyre 3 kanë arritur pajtim dhe 14 ndarje.

Nga këto familje janë 32 fëmijë, prej tyre 18 i janë besuar nënës në përkujdesje, ndërsa 14 ju janë besuar babait në përkujdesje.

Fëmijët pa kujdes prindor

Kemi pasur 2 fëmijë të braktisur të bartur nga viti i kaluar, kurse gjatë këtij viti kemi 2 fëmijë të braktisur, gjithsej 4 fëmijë, ku janë ofruar këto shërbime. Pas qëndrimit në spital për një periudhë një mujore fëmijët janë regjistruar, ju është caktuar kujdestari ligjor; 2 raste të bartura nga viti i kaluar janë në procedurë adoptuese; 2 rastet e braktisjes së këtij viti kanë kaluar në bashkim familjar, një fëmijë te nëna, një te babai; 5 raste janë në procedurë për vërtetim të atësisë; 1 fëmijë është vendosur në SOS fshatin Prishtinë, pastaj janë vendosur në strehim familjar në komunitet, kurse fëmija tjetër i braktisur është adoptuar; 2 fëmijë janë vendosur në strehim familjar në komunitet; 1 fëmijë i prindërve të penguar në detyrën prindërore i bartur nga vitet e kaluara është në mbrojtje institucionale, i strehuar në Caritas Klinë dhe 1 fëmijë është trajtuar me formën mbrojtëse strehim familjar në komunitet.

Gjatë këtij viti i kemi pasur kërkesat për kujdestari të veçanta, kemi caktuar kujdestar ligjor për 7 raste, me rastet e bartura nga vitet paraprake, gjithsej 17 kujdestari aktive.

Personat e moshuar

Sikurse edhe kategoritë tjera të mbrojtjes sociale edhe këto kategori të moshës së pleqërisë kanë pasur tendencën e rritjes, mirëpo në këtë periodë rëndësi të veçantë i kemi kushtuar sidomos të moshuarve pa kujdes familjar ku i kemi pasur të vendosur 3 raste: 2 në shtëpinë e pleqve Skenderaj dhe 1 në Prishtinë, 1 kërkesa te reja, 1 kërkesë është në procedurë për tu vendosur ne shtëpi të pleqve Prishtinë, dhe janë dhënë 2 raporte për bashkim familjar tek të afërmëve jashtë shtetit.

Kategori dhe shërbime tjera

Në Qendër për Pune Sociale ofrohen shërbime edhe për këto kategori janë dhënë:
Vërtetime për lirim nga shtetësia e Kosovës 38
Certifikata për zotësi të veprimit për punë dhe për armëmbajtje 184,
Asistime ne polici për fëmijët e mitur dhe raste te dhunës në familje 50,
Pjesëmarrje ne seancë gjyqësore 75,
Vizita në familje 29,
Kontaktim prind fëmijë 95,
Seanca konsultime dhe këshillime 168
Bashkëpunim me Institucione 79
Konstatime Zyrtarë 17
Regjistrim i më vonshëm i fëmijëve 3 etj.
Gjate këtij viti janë mbajtur 2 komisione mjekësore për fëmijët me aftësi të kufizuar në muajin Shkurt, kanë aplikuar 35 raste te reja, kemi pasur 4 ankesa, 27 janë miratuar 6 plotësime dhe 5 janë refuzuar. Është punuar në bazë të shërbimeve sociale, bazën e strehimit familjar dhe bazë të fëmijëve me aftësi të kufizuar gjithsej 50 raste. Gjatë këtij viti është bërë lëshimi i një baze të re online për dhunën në familje.

Shtëpia Rezidenciale Lumadh

Aktivitetet shëndetësore dhe vizitat familjare brenda dhe jashtë shtëpisë për periudhën Janar-Qershor 2023 te pacientëve:

| Emri dhe Mbiemri | Vizite ne Familje | Vizite ne SH.R |
|---|---|---|
| 1. I.G | 4 | 1 |
| 2. R.B | 6 | 0 |
| 3. D.S | 2 | 1 |
| 4. G.O | 1 | 4 |
| 5. E.G | 1 | 6 |
| 6. A.S | 1 | 4 |
| 7. A.M | 0 | 0 |
| 8. L.K | 0 | 0 |
| 9. A.K | 0 | 0 |
| 10. A.M | 0 | 4 |
| Gjithsej | 15 vizita në Familje | 20 vizita ne Shtëpinë e Komunitetit |
| Vizitat Mjekësore Brenda dhe Jashtë | Vizita ne QKMF janë : 3 | Vizita mjekësore ne SH.K: 1 |

| |
|---|
| **Raste të vdekjes : 1 N.G** |
| **Vaksinim me dy doza te Pfizer** |
| **Konsultime me telefon me ndihmën e shpejte 2 here.** |

Gjendja shëndetësore është stabile përjashtimit disa gripa sezonal tek disa prej pacienteve si dhe me disa probleme dentare te cilat janë evidentuar ne QKMF-ne e Fshatit Lumadh.

Puna Individuale me Rezidente Ka si pike synimi qe rezidentet te marrin asistence individuale nga punëtoret dhe te ndjejnë siguri ne veprimet e veta dhe kjo arrihet me vete përmbajtje dhe durim te madh tek punonjësit social pasi qe veprimet e rezidenteve janë te ngadalshme dhe te pa koordinuara varësisht shkallës se zhvillimit psikik , andaj kujdesi është maksimal.

**Inspektimet**

Drejtoria Për Inspektime - Vushtrri gjatë kësaj periudhe aktivitetet e veta i ka përqendruar në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë dhe akteve tjera ligjore me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira operatorëve ekonomik në aplikimin e dispozitave ligjore .

| Sektori i Inspektoratit | Numri i Inspektorëve | Procesverbale | Fletparaqitje | Aktvendime/Urdhëresaa | Mbyllje të lokaleve përkohsishtë | Gjoba mandatore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Inspektorati i Tregut** | 4 | 218 | - | 87 | 3 | 10 |
| **Inspektorati i Ndërtimtarisë** | 1 | 57 | - | 4 | - | - |
| **Inspektorati i Komunikacionit** | 1 | 72 | - | 34 | - | - |
| **Inspektorati i Shërbimeve Publike** | 2 | 47 | - | 38 | - | 9 |
| **Totali** | **8** | **394** | - | **163** | **3** | **19** |

SUBJEKTE AFARISTE TE PAJISURA ME PËLQIM MBI PLOTËSIMIN KUSHTEVE MINIMALE TEKNIKE PËR OBJEKTET E SHITJES ME PAKICË E SHUMICË DHE PËR NDËRMJETËSIM NË TREGTI

| | |
|---|---|
| APLIKUAR | 82 |
| TË VENDOSURA | 76 |
| NË PROCEDURË | 2 |
| TË REFUZUARA | 4 |
| Mjete të inkasuara | 5320.00 € |

TË HYRAT NGA DREJTORIA PËR INSPEKTIME

| | |
|---|---|
| Pranime teknike | 5320.00 € |
| Gjoba mandatore | 2325.00 € |
| Pranime teknike të automjeteve | 310.00 € |
| Asgjësimi i mallit | 150.00 € |
| Totali i të hyrave | **8105.00 €** |

Inspektorati i Tregut

Aktivitetet e inspektimit :

- Subjekte afariste ku frekuentimi i konsumatorëve është më i madh
- Subjekte afariste qe shesin mallra jo ushqimor (teknik të bardhë)
- Dyqanet e pa varura hoteliere, shërbyese
- Subjektet të cilat kanë zgjatur orarin e punës, respektimi i orarit sipas kritereve të përcaktuar me Rregullore Komunale
- Inspektimi i bizneseve të reja
- Siguria e përgjithshme e produkteve
- Luftimi i të praktikave të padrejta tregtare si dhe parandalimi i tregtisë informale.
- Mbrojtja e konsumatorit
- Mbrojtja e shëndetit publik duke kryer kontrolla të rregullta në sigurinë e përgjithshme të produkteve.
- Parandalimin e tregtisë informale

Malli i larguar nag shitja dhe qarkullimi dhe mall i asgjësuar - Inspektorati i Tregut

| | | |
|---|---|---|
| Mall i asgjësuar | | 9700 kg |
| Mjete të inkasuara nga asgjësimi i mallit | 1 x 150 | 150.00 € |

Gjoba të aplikuara nga Inspektorati

| | |
|---|---|
| APLIKUAR | 19 |
| TË VENDOSURA | 11 |
| Mjete të inkasuara në € | 2325,00 € |

**Vërejtje :** Të gjitha pagesat e gjobave janë të kryera me 50 % të pagesës mbështetur në Ligjin Për Kundërvajtje 05/L-087, ndërsadisa gjoba tjera të shqiptuara nga Inspektorati i Tregut janë të hyra në MINT.

## Inspektorati i ndërtimit

Gjatë kësaj periudhe, Inspektorët e Ndërtimit kanë kryer inspektime në bazë të ligjit dhe rregulloreve që janë në fuqi për fushën e ndërtimit.

Për këtë periudhë janë kryer inspektime lidhur me ndërtimet e objekteve të ndërtimit të lartë dhe të ulët, duke kontrolluar terrenin e komunës së Vushtrrisë, ndërprerjen e të gjitha ndërtimeve pa leje, kontrollimin e objekteve me leje ndërtimi, rrënimin e objekteve pa leje.

Për të ardhur deri te një analizë sa më e saktë e punëve kemi bërë grumbullimin e të dhënave për aktivitetet a planifikuara dhe atyre të realizuara, duke nxjerrë statistika e deri te rekomandimet për të rritur efikasitetin në punë.

Aktivitetet:

Gjat kontrollimit të terrenit, janë përpiluar procesverbalet dhe Aktvendime për ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi.
Ndërprerja e ndërtimeve pa leje ndërtimi, ndalimi i punimeve është urdhëruar me afat kohor menjëherë si dhe janë vendosur shirit rrethues të cilët ndalojnë punimet pa leje deri në pajisjen me dokumentacion përkatës të lejes ndërtimore, shumica e ndërtimeve pa leje janë shtëpi banimi, por ka edhe objekte afaristë.
Kontrollimi i objekteve me leje ndërtimi,

## Procesverbale

Procesverbalet janë lëshuar për ndërtimet të bëra pa leje ndërtimi dhe pa pëlqime urbanistike, kryesisht për ndërtime të banimit individual, por ka pas edhe raste të ndërtimeve për të cilat kërkohen pëlqimet urbanistike, siç janë: terrasat para objekteve, ndryshimet në objektet ekzistuese me leje ndërtimi, ndryshimet në kulmet e objekteve dhe në fasadat e tyre.

## Vendime për ndërprerjen e ndërtimeve pa leje ndërtimi

Vendimet për ndërprerje të punimeve janë lëshuar për objektet që kërkohet leja e ndërtimit por të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi, vendimet për ndërprerjen të punimeve kanë karakter të urdhëresës së prere për ndërprerje të punimeve deri në pajisje me leje ndërtimi.

## Inspektorati i Komunikacionit

Gjatë zbatimit të planprogramit të hartuar nga inspektorët e komunikacionit për gjashtmujorin e parë kemi lëshuar: procesverbale, vendime për pranime teknike të autotaksive si dhe janë inkasuar mjete bazuar në vendime.
Me qëllim të përmirësimit të gjendjes së transportit rrugor në territorin e Komunës së Vushtrrisë janë marrë masa konform dispozitave ligjore si dhe inspektimet janë kryer në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Stacioni në Vushtrri.
Qëllimi i inspektimit - Mbikqyrja dhe inspektimi i të gjithë operatorve që merren me veprimtarinë mbi transportin e udhëtarve dhe mallrave, që qarkullojne në territorin e Vushtrrisë:

- Inspektimi i Autotaksive;
- Operatorët "Taksi";
- Ndërmarrjet të cilat merren me transport të udhëtarëve;

- Ndalimi i operatorëve ilegal, masat e ndërmarra ndaj tyre;
- Kushtet teknike të automjeteve;
- Inspektimin e automjeteve të transportit të mallrave;
- Kontrollimin e linjave urbane dhe urbano-periferike.

Inspektorati i Shërbimeve Publike

Gjatë punës gjashtëmujorë 2023 janë bërë inspektime dhe mbikëqyrje të vazhdueshme bazuar në rregulloren komunale që e rregullonë këtë lëmi. Janë ndërmarë të gjitha masat administrative të nevojshme për arritjen e objektivave të përcaktuara sipas planit të gjashtëmujorit të parë 2023.

Angazhimi për mbikëqyrjen e pastërtisë së qytetit me rrethinë dhe objektet komunale ka qenë në përditshmëri e vazhdueshme po ashtu kemi bërë inspektime të mbikëqyrje të rregullta papastërtisë rreth objekteve banesore dhe përcjelljen e hedhjes së hedhurinave në kontenjer nga banorët, kemi inspektime të kohëpaskohshme për gjatë ditëve të tregut me qëllim të mbarëvajtjes së trotuareve dhe hapësirave publike të zëna nga shitësit ambulant.

Angazhime të rregullta kanë qenë edhe në mbikëqyrjen e rrjedhjes se ujit, vetëm në raste kur kemi konstatuar dhe në rastet e caktuara me kërkesë të qytetarëve kemi urdhëruar KRU-Ujësjellësi për të bërë sanime të menjëhershme. Të gjitha kërkesat e qytetarëve të cilat i janë drejtuar për Inspektoren e Higjienës Komunale – Shërbimeve Publike janë zgjidhur brenda afateve ligjore.

Në këtë periudhë Inspektorja e Higjienës Komunale - Shërbimeve Publike ka bërë kontrollime inspektuese në rrugët e qytetit dhe të fshatrave. Kemi 37 shënime zyrtare. Nga inspektimet dhe konstatimet janë hartuar 47 procesverbale, 38 urdhëresa dhe 3 gjoba mandatore.

## Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Vushtrrisë ka vazhduar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për trajtimin e kërkesave në kuadër të: Sektorit të Urbanizmit, Planifikimit, Legalizimit, Mjedisit dhe Zyrës së Adresave si dhe Shërbimet Juridike.

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2023, kryesisht janë mbajtur takime të organizuara nga sektori i planifikimit urban për çështjet e rregullimit urban (te prezantuara në vijim), pjesëmarrja ne konferenca te organizuara nga niveli qendror dhe grupe tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, takimet e rregullta me komunitetet e zonave të ndryshme, propozimet e ndryshme për rregullimin e infrastrukturës dhe është punuar në rritjen e bashkëpunimit në mes të DUMM me drejtoritë e tjera për qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe efikasitetit për realizimin e qëllimeve të përbashkëta në dobi të Komunës së Vushtrrisë.
-DUMM sa i përket planeve hapësinorë ka Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024 i cili është një plan strategjik multi-sektorial dhe i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës përfshin planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë prej së paku tetë (8) vjeçare.

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2023, DUMM ka zbatuar në përpikëri Planin Zhvillimor Komunal ku zyrtarët përgjegjës gjatë çdo shqyrtimi të kërkesave të pranuara që kanë të bëjnë me ndërtime dhe informime tjera rreth destinimit të parcelave kadastrale të tyre janë udhëzuar me destinimin e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal po ashtu kërkesat e parashtruara për marrjen e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore

dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve për kategorinë e parë (I) dhe të dytë (II ) janë trajtuar me përkushtim të lartë dhe në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunalë (PZHK-lë) 2016-2024.

DUMM është në partneritet që nga viti 2019 me UN Habitat Kosova në hartimin e Hartës Zonale për komunën e Vushtrrisë, drafti final është në përfundim e sipër.

Sektori I Urbanizmit

Gjatë periudhës janar-Qershor për vitin 2023 është marr me shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me kushtet e lokacionit, lejeve ndërtimore, lejeve paraprake, leje për rrënimin e objekteve, leje përdorimi të objekteve, informacione për destinimin e sipërfaqeve nga planet përkatëse rregulluese duke kaluar nëpërmes procesit të daljes në teren dhe incizimit të gjendjes faktike ne terren ku përmes sektorit për planifikim urban e ka vazhduar procesin e mëtutjeshëm për finalizim.

Lejet ndërtimore:

-Vendim për Leje ndërtimore.........16;
Për objekte të kategorisë I – 9 Leje ndërtimore
Për objekte të kategorisë II - 7 Leje ndërtimore.
-Në procedurë: 3
Ju janë aprovuar kërkesat kompanive si KEDS, IPKO , për shtrirjen e rrjetit nëntokësor vendosjen e ormanëve MDF.

Sektori për Planifikim Urban

Gjatë periudhës gjashtëmujorë është bërë sistematizimi i lendeve të ndryshme, koordinimi profesional dhe ligjor brenda drejtorisë, zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, kontrollimi i rregullt i projekteve kapitale, zgjidhje dhe përgjigje të kërkesave të qytetarëve, përgatitja e projekteve konkurruese ideore, vizitat e punimeve në teren-mbikëqyrja e projekteve , monitorimi dhe aprovimi për Kushte dhe leje Ndërtimore, pranime teknike të disa projekteve, mbajtja e disa seminareve të organizuara nga organizata të ndryshme, takimet me grupet punuese, Me UN-Habitat për punimin e Hartës Zonale.

- Vendime për caktimin e kushte ndërtimore................21
- Për objekte të kategorisë I - 11 kushte ndërtimore
- Për objekte të kategorisë II - 10 kushte ndërtimore.

Në bashkëpunim me UN Habitat Kosova është punuar në hartimin e raportit të vlerësimit Lokal për lokalizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (bashkë punim me UN Habitat).

Sektori për Mbrojtjen e Mjedisit

Drejtoria ballafaqohet me një numër mjaft të vogël të stafit e cila e bënë të pamundur zbatimin sa më efikas të detyrave dhe përgjegjësive përkatësisht në sektorin e mbrojtjes së mjedisit ku jemi vetëm me një zyrtar të vetëm.
Në respektim të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimit Administrativ për dhënien e Lejeve Mjedisore Komunale kemi lëshuar me kërkesën e palëve kemi shqyrtuar dhe nxjerr 8 vendime për leje Mjedisore Komunale .

Legalizimet

Janë shqyrtuar gjithsejtë 288 kërkesa dhe janë marrë vendime si vijon:
-Vendim për Legalizim..........................................................................96
  Kategori I........90
  Kategori II.......6
-Plotësim dokumentacioni...........................................................................154
-Lista e pritjes. ...........................................................................................38
-Informim për taksë ......................................................................................7
-Dërgesë dokumentacioni - dorëzim palës.....................................................63

Sistemi i adresave

Në respektim të Ligjit për sistemin e Adresave dhe Udhëzimeve Administrative të gjitha palët (103 raste ) janë njoftuar për adresa në Sistemin e Adresave ARIS.

Sfidat e drejtorisë

Si sfidë kryesore e drejtorisë në realizimin e qëllimeve dhe objektivave është mungesa e stafit në numër si dhe në aspektin e përgatitjes profesionale. Si sfidë e të ardhmes mbetet angazhimi i të gjithë stafit për respektimin e afatit të përcaktuar ligjor, për përfundimin e kërkesave të palëve, e po ashtu sfidë tjetër mbetet gjetja e metodave për vetëdijesim të qytetarëve që të pajisen me leje përdorimi-certifikatë të përdorimit për ndërtesat që paraprakisht janë pajisur me leje ndërtimi si dhe për legalizimin e ndërtimeve pa leje. Synimi i drejtorisë është gjithashtu dhe realizimi me sukses i të gjithë projekteve për investimet kapitale të buxhetuara në kuadër të drejtorisë.

## **Shërbimet Publike**

Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë përpjekje për të ofruar shërbime sa më cilësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, prandaj mbështetur në planin e punës së kryetarit të komunës.
Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar takime dhe konsulta të shumta me Kompanitë Publike, përfaqësues të fshatrave dhe lagjeve në lidhje me investimet në infrastrukturë të miratuara qoftë nga Kuvendi Komunal qoftë nga pushteti qendror si dhe mundësinë e participit nga ana e komunitetit. Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve pas shqyrtimit në nivel të Drejtorisë, janë dërguar në procedura të mëtutjeshme për vendosje, siç është Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi i Komunës. Është vlerësuar se nevojat dhe kërkesat e qytetarëve për rregullimin e infrastrukturës dhe problemeve tjera komunale, janë shumë të mëdha por për shkak të buxhetit të limituar dhe gjendjes jo të mirë ekonomike të vetë komunitetit, zgjedhja e këtyre problemeve është e vështirësuar.

Furnizimi me ujë
Sa i përket furnizimit me ujë të pijes, nga marsi i këtij viti, fabrika për prodhimin e ujit në Balinc ka vazhduar të operojë me orar të plotë 24 h në ditë. Është bërë studimi i fizibilitetit nga komisioni i përbashkët në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Ndërmarrjes KRU „Mitrovica" për zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë për vendbanimet e pjesës lindore të komunës. Kemi vazhduar me implementimin e projektit për kyçjen e ekonomive familjare në rrjetin e ujësjellësit dhe vendosjen e pompave në fshatin Smrekonicë dhe Sfaraqak për të rregulluar furnizimin e këtyre lokaliteteve me ujë të pijes, ndërsa është në procedurë vendosja e sistemi të pompimit për fshatrat Vilanc, Ropicë dhe Samadrexhë.

Largimi i ujërave të zeza. Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2023 janë hartuar paramasat dhe parallogaritë për investime dhe janë zhvilluar procedurat për nënshkrimin e kontratave dy vjeçare. Ndërsa është bërë ç'bllokimi i një numri të konsiderueshëm të gypave dhe pusetave të bllokuar.

Largimi i ujërave atmosferike Në kuadër të planit të punës së drejtorisë, me planin financiar, është paraparë që të intervenohet në pastrimin e pusetave të kanalizimit atmosferik. Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të prrockave dhe rrjedhave të ujit në qytet, përmes kontratës me Ndërmarrjen UNITETI.

Menaxhimi i Mbeturinave Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë, ka caktuar grupin teknik për hartimin e planit ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave brenda regjionit, i cili plan pritet të hartohet deri në fund të vitit. Si rezultat i këtyre angazhimeve, Komuna e Vushtrrisë është duke bërë ofrimin e shërbimit për të gjitha vendbanimet e komunës. Gjithashtu është duke u bërë grumbullimi i ndarë i mbeturinave të rreth 1500 ekonomive familjare, të cilat janë duke u paketuar në qendrën për paketim në Bukosh.. Po ashtu është bërë eliminimi i qëndrueshëm i deponive ilegale si deponia në fshatin Bajskë dhe aktualisht i kemi vetëm gjashtë deponi të tilla.Si rezultat i këtij angazhimi ndërmarrjes „UNITETI'' i është siguruar një stabilitet financiar dhe kemi arritur që në masë të madhe ta përmirësojmë gjendjen e ambientit. Është ky viti i dytë prej themelimit të Ndërmarrjes Lokale „Përparimi", përmes së cilës janë ofruar shërbimet e sigurimit dhe pastrimit të objekteve si dhe është bërë mbjellja e luleve dekorative si dhe mirëmbajtja e hapësirave publike.
Ndriçimi publik Ka vazhduar implementimi i kontratës për mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit publik, si dhe është realizuar kontrata për zgjerim të rrjetit të ndriçimit në vlerën 18,863.80 € cila është në fazën e vlerësimit.

Komunikacioni
Në kuadër të fushës së trafikut, është menaxhuar kontrata për shërbimet e transportit me auto merimangë, janë nxjerrë vendime për bllokim të shiritave rrugor dhe vendime për shfrytëzim të parkingjeve nga operatoret e transportit të udhëtarëve me Radio Taksi, vendime për ndaljen e mjeteve motorike për ngarkim shkarkim.
Në fushën e trafikut ka vazhduar implementimi i kontratës për furnizim dhe vendosje të sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrugët e qytetit dhe emërtimet e vendbanimit, me qëllim të krijimit të një rrjeti funksional dhe të integruar, duke synuar rritjen e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, pra krijimin e kushteve për lëvizje të motorizuara dhe të pa motorizuara, duke

përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta, ndërsa jemi në përpjekje që së bashku me UN – HABITATIN të bëjmë hartimin e planit të mobilitetit.
Gjithashtu është shpallur konkursi për ndarjen e linjave të transportit urbano-periferik në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
Gjatë periudhës së parë të vitit, ka vazhduar mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara përmes kontratës për rikonstruim dhe mirëmbajtje të rrugëve, me ç'rast janë riparuar mjaft segmente rrugore me asfalt dhe me kubëza dhe të një numri të konsiderueshëm të pusetave dhe ndërrim të gypave të kanalizimit.

## Kulturë Rini Sport

Në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport veprojnë sektorë të ndryshëm, andaj edhe raporti i punës së kësaj drejtorie paraqitet sipas sektorëve. Sa i përket mbarëvajtjes së punëve në këtë periudhë kohore, jemi munduar që të bëjmë më së miri punën që është kërkuar nga ana jonë. Në vazhdim paraqesim të dhëna mbi punën vjetore sipas sektorëve të DKRS-së:

### QENDRA E KULTURËS "HASAN PRISHTINA"

Stafi i Qendrës për Kulturë "Hasan Prishtina" gjatë këtij viti ka mbështetur apo ka organizuar të gjitha aktivitetet kulturore që janë organizuar nga institucionet komunale. Po ashtu, ka ndihmuar në organizmin e aktiviteteve të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së për organizimin e Akademive komemorative për veteranë të luftës që kanë ndërruar jetë si dhe aktiviteteve të ndryshme në të cilat është kërkuar ndihma jonë, qoftë nga organizatat rinore, grupet e intelektualëve apo shkollat e komunës së Vushtrrisë, që vlen të përmendet organizimet e shumta që janë bërë në këtë vit nga shkollat fillore, kryesisht me klasat e para dhe të pesta, por edhe shumë të tjera. Ne, në vazhdimësi kemi mbështetur, por edhe kemi marrë pjesë në organizimin e shumë takimeve letrare, si promovime të librave të ndryshëm në territorin e komunës sonë por edhe jashtë, kryesisht të autorëve vushtrrias.

Gjithashtu, janë mbështetur edhe shumë artistë për organizimin e ekspozitave të tyre, në Galerinë e Arteve në Qendrën e Kulturës, si dhe aktorëve për realizimin e shfaqjeve që janë dhënë në Teatrin e Qytetit "Adem Mikullovci". Një punëtor i QK "Hasan Prishtina" mban në vazhdimësi të hapur dhe përkujdeset për Kalanë e Qytetit. Vlen të përmendet se në këtë vit kemi qenë të angazhuar edhe në organizimin e disa akademive përkujtimore, për nder të disa personaliteteve të rëndësishme nga Vushtrria.

Në aktivitetet e zakonshme që i organizojmë si drejtori, por edhe aktivitet tjera të organizuara qoftë nga Kryetari i Komunës apo Drejtoria e Arsimit apo edhe sektorët e tjerë të DKRS-së ne kemi qenë të angazhuar në mbarëvajtjen e atyre organizimeve, qoftë në mbështetje teknike me mjete të zërimit apo edhe mjete tjera teknike.

Ndër aktivitetet kulturore që kemi organizuar apo që kemi marrë pjesë veçojmë:

Akademi përkujtimore për dëshmorin Xhevat Jusufi, në Smrekonicë;
Organizimi i ceremonisë për ndezjen e qirinjve në rastin e përkujtimit të Masakrës së Reçakut;
Organizimi i Akademisë përkujtimore me rastin e zbulimit të lapidarit të dëshmorëve të rënë në Stanoc, Sadri Maksuti e Sadik Malaj;
Organizimi i koncertit për fëmijë nga Kori i fëmijëve "OKARINA";

Shfaqja "SISTERS" nga Baleti Kombëtar i Kosovës, nën koreografinë e Mehmet Balkan, njëkohësisht edhe hapja e Baletit në Vushtrri;
Organizimi i Promovimit të librave të autorit Fetah Berisha;
Akademi Solemne për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës;
Akademi për Ditën e Mësuesit, e cila u organizua nga Drejtoria për Arsim, si dhe një ekspozitë me punime artistike të nxënësve të Gjimnazit "Eqrem Çabej", në Vushtrri;
Organizimi i punëve teknike për tubimin e kryetarit me fermerët vushtrrias, që u mbajt në Qendrën e Kulturës;
Aktivitete me fëmijë për Ditën Botërore të Autizimit;
Akademi përkujtimore për veteranin e luftës së UÇK-së, Zymer Krasniqi;
Akademi përkujtimore për veteranin e luftës së UÇK-së, Ismet Hoxha;
Akademi përkujtimore për veteranin e luftës së UÇK-së, Musfatë Tahiri;
Akademi përkujtimore për veteranin e luftës së UÇK-së, Avni Imeri;
Akademi përkujtimore për veteranin e luftës së UÇK-së, Jonuz Segashi;
Akademi Përkujtimore "Studimja '99";
Akademi përkujtimore për dëshmorin Hamdi Ferati;
Akademi Përkujtimore për nder të përkujtimit të masakrës së 22 Majit në Vushtrri;
Akademi Përkujtimore për Masakrën mbi Familjes Gërxhaliu;
Aktivitete dhe koncert për fëmijë për nder të Ditës së Fëmijëve - 1 Qershori 2022;
Ekspozitë me punime të artistit Haki Haliti;
Promovimi i librit "Ngjyra – ngjyra" të autores Erina Maliqi, nxënëse e klasës së pestë.
Akademi Solemne për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë – 17 qershor 2022;
Ekspozitë me fotografi "Gratë dhe vajzat e UÇK-së" të autores Mirevete Hasani ish-ushtare e UÇK-së, në kuadër të Manifestimit "Dita e Çlirimit.

BIBLIOTEKA "NAIM FRASHËRI"

Të dhënat për periudhën 1 janar – 30 qershor 2023:

1. Biblioteka amë "Naim Frashëri" ka **38477** libra. Në sektorin e fëmijëve janë 12297 libra ndërsa në sektorin e të rriturve janë **26180** libra.
2. Në sektorin për fëmijë janë dhënë për lexim **2831** libra.
3. Në sektorin për të rritur janë dhënë për lexim **2088** libra.
4. Në dy sektorët janë dhënë për lexim **4919** libra.
5. Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar **654** lexues.
6. Janë përpunuar **410** libra.
7. Lexues të ri të regjistruar **96** vetë.
8. Janë dhuruar nga autorë të ndryshëm **164** libra.

Në sektorin për fëmijë librat më të kërkuara për lexim ishin:

**"Lulet e Verës"**, i autorit Naim Frashëri, dhe
**"Luli i vocërr",** i autorit Migjeni.

Në sektorin për të rritur, libri më të kërkuar për lexim ishin:

**"Historia e Skënderbeut"** e Marin Barletit, dhe
**"Historia e Skënderbeut"** e Naim Frashërit.

## MUZEU HISTORIK – ETNOGRAFIK

Objekti i Muzeut të Vushtrrisë, përkatësishtë "Monumenti Mahmut Agë Gjinolli" është një nga objektet e përfshira në projektin "EU for All – UE për të gjithë" mbështetur nga Bashkimi Europian në Kosovë. Projekti ka filluar të implementohet më 8 maj 2023, falë të të cilit do ju mundësohet qasje e lehtë të gjithëve, në veçanti personave me nevoja të veçanta, duke ju lehtësuar vizitat dhe pjesëmarrje në aktivitetet edukative e kulturore në objektin e muzeut.
Muzeu u pasurua me mbi dyzet eksponate nga materiale të ndryshme të dhuruara.
Sektori i fototekës u pasurua me 23 fotografi të vjetra familjare të Vushtrrisë, të realizuara kryesisht në fund të shek. XIX dhe fillim të shek.XX.

Edhe gjatë vitit 2023 muzeu organizoi aktivitete të cilat qëllimin kryesor kishin promovimin, edukimin dhe vetëdijesimin e gjeneratave të reja përmes komunikimit muzeor. Gjithashtu, stafi i muzeut ishte pjesë edhe e aktiviteteve të shumta kalendarike të organizuara në kuadër të DKRS-së.

## SEKTORI I RINISË

Së bashku me Qendrën Rinore, OJQ-të, dhe grupet joformale u diskutua dhe planifikua për projektet që do të realizohen gjatë vitit 2023.
Në bashkëpunim me bordin e KVRL-së, u diskutua dhe planifikua për projektet që do të realizohen gjatë vitit 2023, po ashtu u diskutua edhe për ristrukturimin i këtij këshilli që do të bëhet gjatë këtij viti.

Janë njoftuar të gjitha OJQ-të rinore, KVRL-ja, Qendra Rinore si dhe grupet jo formale të të rinjve për thirrjen publike për mbështetje financiare nga Komuna, po ashtu janë njoftuar edhe për thirrjet nga MKRS-ja, njëherësh do t'u ofrohet mbështetje aq sa do të jetë e mundshme në kapacitetet tona
Takime pune dhe informues me përfaqësuesit e OJQ- ve rinore gjatë takimeve me ta është bërë planifikimi dhe janë hartuar projekt propozime dha janë dërguar për mbështetje në MKRS dhe USAID-ATRC, OSCE dhe organizata tjera.

Takime pune dhe bashkëpunim me OSCE, ku janë plotësuar disa pyetësor që janë dërguar nga ta edhe njëherë OSCE ka shpreh gatishmëri që të bashkëpunojë në aktivitete të ndryshme në fushat të cilat mund të na ndihmojë OSCE-ja.
Qendra Rinore "Hareja" ka mbajtur trajnime për Rrobaqepësi dhe Modë për të gra dhe vajza të grup moshave të ndryshme, në fund të këtyre trajnimeve pjesëmarrësve në trajnime u janë ndarë edhe certifikata për ndjekjen e trajnimeve. Ky projekt është mbështetur nga IOM dhe është asistuar nga sektori i rinisë.
Takime me kryetarin e KVRL-së, në këto takime u planifikua për projektet që parasheh të organizoj KVRL, po ashtu diskutua për sfidat dhe problemet që ka KVRL e një ndër to edhe hapja e llogaris nga KVRL si dhe çështje të ndryshme rreth KVRL-së.
Organizata Rinore "Access" në bashkëpunim me sektorin e rinisë dhe Departamentin e Rinisë – MKRS ka planifikuar që të organizojnë trajnime për të rinjtë në komunën e Vushtrrisë, është hartuar projekt propozimi dhe do të dërgohet për financim.
Takime pune me përfaqësuesit e Strategjia Rinore dhe KVRL – së ata kanë, shprehur vullnet për të

hartuar një projekt për hartimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal, Në fund të këtij projekti do të hartohet PVRL për tri vitet e ardhme.
Takim me përfaqësuesin e OJQ "Kosova Serwas" me të u diskutua për projektet që parasheh të realizojë kjo OJQ, për formën e aplikimit dhe qasje ne fonde te donator të ndryshëm.
Është në realizim e sipër projekti "Komuna për të Rinjtë'' ky projekt realizohet nga Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Bankës Botërore si dhe organizatës facilituese CDF. Gjysma e pare e projektit është realizuar ndërsa ky projekt do të vazhdojë edhe me gjysmën tjetër, realizimi i këtij projekti do të ketë një ndikim të mire për zhvillimin e aktiviteteve rinore, pasi që shuma totale për mbështetjen e të rinjve në total arrin vlerën 250'000.00 dollar amerikan.
KVRL në bashkëpunim me organizatën "Domain for Kosovo" kanë mbajtur sesion informues për të rinjtë në shkollat e mesme, ky sesion ka për qëllim informimin e të rinjve për themelimin dhe punën e KVRL-së si dhe promovimin e Domenit shtetëror për Kosovë.

SEKTORI I SPORTIT

Gjatë vitit 2023 konkretisht me datë 15.07.2023, nën patronatin e Kryetarit të Komunës është organizuar gara për thyerjen e rekordit të Guinessi nga sportisti Vushtrrias Bujar Muli, për bartjën e peshës më të rëndë, në prani të komisionit të certifikuar, ky rekord u thy me sukses nga garuesi në fjalë duke e barturë peshën 1531kg.

KLUBET SUPERLIGES

1.KLUBI FUTBOLLIT "VUSHTRRIA " ka humbur mundësin që të bëhet anëtar i superligës për këtë sezon dhe prap ka mbetë në Ligën së Parë të Futbollit.

2. KLUBI HENBOLLIT "VUSHTRRIA" (M) ka arritur që të jetë në top 4(katër) skuadrat me të mira në Henbollin Kosovar, edicionin e ri garues do të jetë pjesëmarrëse edhe në garat ndërkombëtare.

3.KLUBI HENBOLLIT "VUSHTRRIA"(F) është shpallur nënkampion Superliges për edicionin 2022/2023 dhe ka të drejtë përfaqesimi në arenen ndërkombtare.

4.KLUBI HENBOLLIT " SAMADREXHA" (M) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka ruajtur statutin e Ligës së Parë duke u renditur e dytë (2)

5. KLUBI HENBOLLIT " SAMADREXHA" (F) ka garuar në Superligë , dhe ka ruajtur statutin e Superliges duke u renditur e nënta (9).

6. KLUBI BASKETBOLLIT "VUSHTRRIA" (M) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka ruajtur statutin e Ligës së Parë duke u renditur e dytë (2).

7. KLUBI BASKETBOLLIT "VUSHTRRIA BASKET" (F) ka garuar në Ligën e Parë dhe ka arriturë që të jetë në vendin e tretë, gjatë edicionit garues 2022/2023

8.KLUBI VOLEJBOLLIT "ASVUSHTRRIA" (M) ka garuar në Superligë , dhe ka mbeturë në vendin e fundit në edicionin garues 2022/2023.

9. KLUBI VOLEJBOLLIT "AS VUSHTRRIA" (F) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka arriturë që të jetë në vendin e parë në Ligen e Parë Lindje, për sezonin 2022/2023.

10 . KLUBI VOLEJBOLLIT "VUSHTRRIA" (F) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka ruajtur statutin e Ligës së Parë duke u renditur e dyta (2).

11. KLUBI I FUTSALLIT FC "VUSHTRRIA" ka garuar në Ligën e parë, dhe ka arriturë që të ruaj statutin në ligën e parë duke u renditurë e dyta (2) në edicionin garues 2022/2023.

KLUBET E KATEGORIVE TË REJA

1.KLUBI FUTBOLLIT " VUSHTRRIA " Kampion U 18 , Liga Regjionale.

2. KLUBI FUTBOLLIT " VUSHTRRIA" Kampion U 17 , Liga Regjionale.

3. KLUBI FUTBOLLIT "EL CLASICO " Fitues I Kupes U 17 , Liga Regjionale .

4. KLUBI FUTBOLLIT " FORCA " Vendi I Dytë (2) , Liga Regjionale.

5. KLUBI VOLEJBOLLIT " AS VUSHTRRIA " Finalist , U 18 , U 16

6. KLUBI I GJIMNASTIKES ''VUSHTRRIA'' – Gara ndërkombëtare

ARKIVI HISTORIK

Arkivi Historik është institucion i cili pranon, evidencon, rregullon dhe publikon lëndën arkivore, mundëson shfrytëzimin e saj për hulumtime shkencore dhe punë profesionale si dhe për nevoja tjera të cilat janë në interes për organet, organizatat, institucionet, personat civil-juridik.

Arkivi kryen veprimtarinë konform ligjit dhe akteve të përgjithshme juridike, ky institucion punët i kryen nëpërmjet këtyre shërbimeve:

- Shërbimi për mbrojtjen e lëndës arkivore brenda dhe jashtë arkivit
- Pranimi i lëndës arkivore nga institucionet lokale
- Evidentimi dhe rregullimi dhe klasifikimi i dokumenteve arkivore brenda arkivit
- Aktivitete tjera
- Punët e depos, mirëmbajtja, renditja si dhe mbikëqyrja e dokumentacionit
- Punët e udhëheqjes në arkiv
- Aftësimi profesional i punëtorëve

Arkivi Historik i Qytetit-Vushtrri

| | |
|---|---|
| Shërbimi për mbrojtjen e dokumenteve arkivore jashtë arkivit | Në periudhën Janar- Korrik 2023 kemi bashkëpunuar me Kuvendin Komunal Vushtrri , konkretisht me Drejtorinë e Administratës e cila ka përgjegjësin e dokumentacionit i cili gjendet në depon e Komunës . materiali I cili ka qenë në depon e Komunës nuk ka qenë në gjendje të rregullt për shkak të kushteve minimale. |
| Pranimi i lëndës arkivore nga institucionet lokale | Në këtë muajin mars kemi pranuar material të ndryshëm nga Drejtoria e Administratës dhe DKRS së bashku me Arkivin dhe po mundohen të gjejnë forma për mënyrën e sistemimit të materialit të pranuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë edhe pse në mungesë të rafteve .<br>Kërkesa dhe nevoja për të krijuar kushte për pranimin e materialit të Kuvendit Komunal është bërë në fazë emergjente për arsye të kushteve të dobëta si dhe për lirimin e hapësirës për renovimin e depos së Arkivit në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë.<br>Deri më sot janë përgjigjur vetëm Drejtoria e Administratës për rregullimin e lëndës arkivore të dorëzuar në Arkivin e Qytetit. |
| Evidentimi rregullimi dhe klasifikimi dokumenteve | Në periudhën janar – korrik kemi sistemuar dokumentacionin e Gjykatës Komunale në raftet të cilat I ka poseduar Arkivi, dosjet dhe lëndët personale të ndryshme janë sistemuar në ormane të metalit. Shumica e materialit që ka qenë pjesë e Arkivit dhe materialit që është pranuar nuk |

| | |
|---|---|
| brenda arkivit | është e sistemuar në mungesë të rafteve arkivore.<br>Mungesa e rafteve dhe mos ndërprerja e kontratës për furnizim me rafte të sistemit modular paraqet problemin kryesor për sistemin e lëndës arkivore e cila nuk është në gjendje të mirë. |
| Aktivitete tjera | Si njësi arkivore dhe si staf zyrtar kemi bashkëpunuar me DKRS dhe fushat tjera të Kuvendit komunal Vushtrri.<br>Angazhimi në komisione për vlerësim të ofertave të prokurimit, rekrutimit të zyrtarëve komunal si dhe angazhimi për menaxhimin e kontratave për projektet në kuadër të DKRS-së, ishin sfida pothuajse kryesore , pasi që shumë elemente të fushës së prokurimit janë jashtë fushës për të cilën jemi të emëruar. |
| Punët e udhëheqjes në Arkiv | • Arkivi Historik i qytetit menaxhohet nga udhëheqësi dhe stafi Arkivit në bashkëpunim me DKRS-Vushtrri.<br>Në arkivin e qytetit janë dy vende të lira si ndihmës arkivist , kështu që edhe kjo dukuri e pengon punën ekipore e cila duhet të zhvillohet në Arkiv.<br>Verifikimi i lëndëve pronësore bëhet në bashkëpunim me dokumentacionin përkatës të institucioneve si: Gjykata Themelore Vushtrri, Policia e Kosovës, Kuvendi Komunal Vushtrri me drejtorit përkatëse , shkollat etj. |
| Punët e depos, mirëmbajtja, renditja si dhe mbikëqyrja e dokumentacionit | Sa i përket depos ku është i vendosur materiali arkivor i plotëson kushtet dhe kriteret si objekt , por mungojnë raftet të cilat janë të domosdoshme për sistemimin e materialit arkivor.<br>Në këtë periudhë kohore kemi bërë ndarjen dhe klasifikimin e materialit në bazë të rrethanave dhe inventarit të cilit e posedon Arkivi. |
| Aftësimi profesional i punëtorëve | Gjatë këtij viti të punës sa përket aftësimit profesional nuk ka pasur trajnime në drejtim të lëndës së Arkivistikës si lëmi përkatëse për arkiv. |

TEATRI I QYTETIT "ADEM MIKULLOVCI"

Për vitin 2023 janar-qershor kemi realizuar këto shfaqje: Shfaqjen Ariu të autorit Çehov, Kjo që u mirëprit nga publiku.

Më 16 shkurt është shfaqur shfaqja për fëmijë " Tomi dhe Xheri " ishin fëmijët që ju gëzuan kësaj shfaqje Kemi filluar realizimin e shfaqjes për fëmijë "Panda në udhëtim" në muajin mars 2023 mirëpo për shkak të angazhimeve të shumta në sallën e teatrit me manifestime të ndryshme ne këtë shfaqje për fëmijë do ta japim nga muaji shtator.

Ndërsa tani ne kemi filluar përgatitjen e shfaqjes " Çfarë ka parë shërbëtori "dhe presim nga muaji shtator-tetor të dalim me premierë. Teatri edhe me statut e ka që Brenda vitit ti realizoj tri shfaqje por çdo herë duke e ditur se shfaqjet duhet të përkrahen nga komuna e Vushtrrisë .

Teatri është angazhuar edhe në manifestimet tjera që janë organizuar edhe nga DKRS, si tani në manifestimin e "Ditëve të Diasporës".

Teatrit duhet ti ndahet shuma që është aprovuar me kuvend .

## Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Gjatë periudhës 01.01.2023-30.06.2023, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë kryer këto punë:

Janë pranuar 590 kërkesa për regjistrimin e bartjes së pronës. Pas zhvillimit të procedurës administrative dhe studimit të lëndëve ky shërbim ka marr 590 aktvendime me të cilat janë miratuar apo refuzuar kërkesat e palëve, kurse në procedurë administrative për vendosje janë edhe 21 kërkesa (lëndë).
Kemi pranuar nga ana e palëve – qytetarëve 75 kërkesa për korrigjimin e
gabimeve sa i përket emrit apo mbiemrit në regjistrat e pronave, të cilat gabime kanë pasuar nga e kaluara. Pas zhvillimit të procedurës administrative janë aprovuar 69 kërkesa të tilla ndërsa 6 prej tyre janë refuzuar. Këto kërkesa në lidhje me korrigjimin e emrit apo të mbiemrit bëhen pa pagesë.

Janë pranuar 69 kërkesa për regjistrimin e hipotekave dhe 34 kërkesa për çregjistrimin e hipotekave, të paraqitura nga personat fizik dhe juridik.
Pas zhvillimit të procedurës kemi marr 69 aktvendime për regjistrimin e hipotekave dhe 34 aktvendime për çregjistrimin e hipotekave.

Për nevoja të aplikuesëve të ndihmës sociale janë lëshuar 240 certifikata që nuk posedojnë pasuri të paluajtshme si dhe 270 certifikata pronësore. Pasi që përfituesit e ndihmës sociale janë të liruar nga pagesa për shërbimet të tilla nga këto shërbime nuk janë inkasuar mjete financiare.
Janë lëshuar 1412 certifikata pronësore dhe 370 kopje të planit.
Gjithsejtë të hyrat buxhetore për periudhën janar-qershor 2023 nga drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë realizuar 52767.00 euro.
Pranë kësaj drejtorie kemi aprovuar kërkesa zyrtare të ndryshme të parashtruara nga ana e organeve komunale, gjyqësore, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare etj.

### Menaxhimi pronës komunale

Për momentin në menaxhim kemi 25 Kontrata për dhënien në shfrytëzim të tokave bujqësore në pronësi të komunës dhe 28 Kontrata për dhënien me qira të lokaleve afariste në pronësi të komunës.
Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, bazuar në Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës të Komunës, ka përpiluar dhe publikuar në Ueb-faqen e Komunës Listën e përgjithshme të pronave komunale si dhe në mbledhjen e muajit dhjetor, Kuvendi i Komunës ka aprovuar Listën e veçantë të pronave të cilat parashihen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2023..
Gjatë periudhës janar-qershor 2023 nuk janë lidhur kontrata të reja për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.
Vlera e inkasuar nga pronat komunale të dhëna në shfrytëzim për periudhën janar-qershor 2023 arrin shumën prej 6607.10€.
Në mënyrë që prona komunale të menagjohet si duhet dhe në mënyrë efikase, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë rekomandon funksionalizimin e Sektorit të Pronës i cili sektor për momentin nuk është funksional, nuk ka përgjegjës e as punëtor.

### Punët e kryera për nevoja të komunës

Gjatë periudhës raportuese zyrtarët e drejtorisë kan kryer punë të ndryshme për nevoja të Komunës, gjegjësisht të drejtorive tjera gjatë realizimit të projekteve të ndryshme (asfaltim të rrugëve, rregullim të trotuareve, lirim të hapësirave publike etj.)
Për kundër punëve dhe detyrave të punës të kryera në gjashtë mujorin e parë të këtij viti, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ballafaqohet me një serë problemesh të natyrës objektive dhe subjektive si: mungesa e Elaborateve kadastrale, të cilat janë plaçkitur nga okupatori serb në vitin 1999,
Problemet e trashëguara të natyrës pasurore-juridike si uzurpimet, kontestet e bartura nga komasacioni etj.

## Mbrojtje dhe Shpëtim

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka realizuar si vijon:

- Vlerësimi i rrezikshmërisë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës.
- Plani i gatishmërisë emergjente për Komunën e Vushtrrisë.
- Plani komunal për mbrojtje nga zjarri (sipas situatave në terren)
- Plani komunal për reagim emergjent.
- Plani për reagim emergjent gjatë vërshimeve.
- Plani për reagim emergjent në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në ndërtesën e komunës.
- Plani i evakuimit të personelit nga ndërtesa.

Qëllimi i azhurnimit i këtyre planeve është:

- Që të bëhet koordinimi i të gjitha shërbimeve për reagim emergjent në nivel komunal, si dhe asistimi i qytetarëve në rast të fatkeqësive natyrore, teknologjike dhe fatkeqësive të tjera;
- Që të kemi një strukturë të koordinuar civile, shërbimet emergjente komunale (shërbimin e zjarrfikësve dhe shpëtimit, shërbimin emergjent komunal medicinal, kryqi i kuq , OJQ-të ), PK-ën, në mënyrë që këto struktura të jenë të gatshme të reagojnë shpejt dhe me efikasitet në raste emergjente civile.

Me këto struktura jemi në kontakt të përhershëm me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në raste emergjente.

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2023, në DMSH ka pasur angazhime të rregullta por edhe raste emergjente veçanërisht me vërshime ku edhe kemi intervenuar me kompaninë e kontraktuar për angazhim në situata emergjente në terren për eliminimin e disa pikave kritike .
Kemi pasur takime me pjesëtarë të FSK-së, AME-së me Policinë e Kosovës - Stacioni në Vushtrri, KFOR-in , Kryqin e Kuq në Vushtrri, QOR 112.
Në muajin qershor 2023 për shkak të reshjeve të pandërprera me vendim të kryetarit është shpallë gjendje emergjente si dhe është themeluar shtabi për gatishmëri emergjente ku janë marrë masa me qëllim të zbutjes së pasojave dhe dëmëveve nga vërshimet në tokat bujqësore, dëmëet në ekonomitë familjare dhe bizneset private.
Me qëllim të vlerësimit të dëmeve janë themeluar dy komisione: Komisioni për vlerësim të dëmeve në bujqësi dhe komisioni për vlerësim të dëmeve në ekonomi familjare dhe biznese. Këto komisione janë në fazën përfundimtare të vlerësimit të dëmeve.
Në raportin e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim janë paraqitur në mënyrë të detajuar të gjitha masat që janë ndërmarrë në rastet e fatkeqësive natyrore gjatë këtij 6 mujori si nga shtabi emergjent, drejoria, angazhimet e kompanive në terren, vlerësimet e dëmeve ku janë të regjistruar pronat përkatësisht pasuritë e dëmtuara, të paraqitura në regjistrat e qytetarëve të dëmtuar si në ekonomi familjare ashtu edhe në biznese private.

AKTIVITETET E NJPZSH-së GJATË PERIUDHËS JANAR-QERSHOR 2023

| Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int. tjera viti 2023 | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2023 | Nr.i përgj. | Nr.i | Nr. i | Nr.i | Aksidente | Vërshime | Të | Të lënduar | | | Të vdekur | | | Githsejt |
| | i daljeve | zjarreve | Teknike | shërbimeve | rrugore | | rejsh | zj. | qyt. | tot | zj. | qyt. | tot | |
| Janar | 35 | 8 | 11 | 4 | 3 | 7 | 2 | | 2 | 2 | | | | |
| Shkurt | 29 | 11 | 2 | 14 | | | 2 | | | | | | | |
| Mars | 29 | 12 | 8 | 9 | | | | | | | | 1 | 1 | |
| Prill | 22 | 9 | 7 | 6 | | | | | | | | | | |
| Maj | 27 | 4 | 11 | 11 | | 1 | | | | | | | | |
| Qershor | 93 | 9 | 10 | 10 | | 64 | | | | | | 1 | 1 | |
| **Gjithësejt;** | 235 | 53 | 49 | 54 | 3 | 72 | 4 | | | 2 | | | 2 | |

Në këtë raport është paraqitë në mënyrë të detajuar puna dhe aktivitetet e kryetarit – ekzekutivit të komunës gjatë 6 mujorit të parë 2023. Konsiderojmë se është arritur që në masë të kënaqshme të përmbushen objektivat e përcaktuara në planet tona të punës gjate periudhës raportuese për të iu ofruar shërbime sa më cilësore qytetarëve për një jetë dhe mirëqenie më të mirë dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës së tyre përmes projekteve të shumta që janë realizuar dhe do të realizohen.

Tani kur po shqyrtohet ky raport kanë kaluar afër tre muaj nga dita e kur janë paraqitë të dhënat pas përfundimit të muajit të gjashtë dhe natyrisht që janë kryer edhe punë tjera të shumta janë realizuar projekte të cilat nuk janë të përfshira në këtë raport por që do të paraqiten në raportin vjetorë 2023.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës Vushtrri**

Propozuesi :Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi ____________

Hartuesi: Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Remzi Ahmeti ____________

Lënda: Propozim-Vendim për këmbim të pronave.

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040), nenit 24, nenit 25 paragrafi 1,3,4 dhe 6 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 29, 30 dhe 31 të Rregullores (QRK)nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më ________ 2023, mori këtë:

# V E N D I M

Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e rrugës "Ismail Qemajli" në Vushtrri

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Urban Grup" Sh.P.K përfaqësuar nga Fisnik Maloku.

2. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen kanë këto karakteristika: pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-01094-0,në sipërfaqe prej 8.05 m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3441m2 zk Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, me pjesën e parcelës kadastrale P-70202016-06532-0, në sipërfaqe prej 8.05m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2301m2 zk Vushtrri, pronë e "Urban Grup" me seli në Vushtrri.

3. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës publike në fjalë bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.

4. Këto prona ju janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e pronave të paluajtshme pranë Departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe transfereve.

5. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

7. Ku vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjet (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuese e Kuvendit**

______________________

Melihate Basholli-Latifi

# ARSYETIM

